



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 708, datë 04.12.2023**

**PËR**

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...} PËR PERIUdhËN  
2017 - 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017- 2019”, i hartuar nga relatore znj. Irena Plaku,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shumë mirë”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

## **ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI**

### **1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT**

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.*

#### **1.A NJOHURITË LIGJORE.**

*1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.*

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur as me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjor në vendimet burim vlerësimi për gjyqtarin {...}.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:*

- *Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes*

Referuar objektit të mosmarrëveshjes dhe natyrës së çështjes (*civile themeli, familjare, kërkesë civile, gjykim penal themeli ose kërkesë e seancës paraprake*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar në çështjet penale (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), gjyqtari përgjithësisht i përshkruan dhe analizon faktet e çështjes, si të atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe të fakteve që lidhen me themelin, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsyetimit të vendimit.

Paraqitja e rrethanave procedurale, në disa nga vendimet penale apo civile përshkruhen dhe po ashtu analizohen në një nënndarje që përbën pjesën hyrëse të arsyetimit, të titulluar “procedura” ose “aspekte procedurale” në të cilën parashtrohet, përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore<sup>1</sup>, aspektet procedurale të caktimit të seancës, njoftimit dhe pjesëmarrjes së palëve në seancë, sipas parashikimeve të K.Pr.Penale/Civile, si dhe të drejtave procedurale të tyre, për të vijuar me pas, sipas rastit, me ecurinë procedurale të çështjes lidhur me paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar<sup>2</sup>, etj. Por në disa vendime, konkretisht tek vendimet me objekt “pushim gjykimi” apo “dërgim çështjesh në gjykim”, “miratim marrëveshje fajësie”<sup>3</sup> konstatohet se rrethanat procedurale dhe analizimi i tyre bëhet në pjesën e dytë të vendimit, pasi janë parashtruar rrethanat e faktit. Ndërsa në dy vendime, vendimin nr.1407-107, datë 19.06.2018 dhe me nr.673-84, datë 27.04.2017, juridiksioni dhe kompetenca janë analizuar në pjesën e parë të vendimit (pjesën hyrëse).

Në vendimet gjyqësore ku janë marrë në shqyrtim rrethanat procedurale, rrethana të cilat lidhen me shqyrtimin e kërkesave të palëve apo çështjeve të ngritura kryesisht për vlerësim nga gjykata, përshkrimi i fakteve me natyrë procedurale, shoqërohet me vlerësimin dhe analizën ligjore lidhur me këto elementë, posaçërisht në rastet kur ato konsistojnë në shqyrtimin e kërkesave procedurale të palëve, duke i dhënë përgjithësisht qartësi vendimit dhe duke orientuar lidhur me elementë të tillë si: ndërgjyqësia, procedura e gjykimit (*gjykim i shkurtuar në çështjet penale apo riti i shqyrtimit në seancë paraprake*), zhvillimin e gjykimit në prezencë ose mungesë të palëve, pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e tyre në gjykim, legjitimitetin aktiv të palës paditëse në raport me shkakun ligjor dhe objektin e padisë, etj.

Përgjithësisht pas paraqitjes dhe vlerësimit në lidhje me rrethanat me karakter procedural, në vendimet ku këto rrethana përshkruhen dhe arsyetohet në pjesën e parë të vendimi, gjyqtari parashtron faktet e çështjes objekt gjykimi, në një nënndarje të titulluar “Rrethanat e çështjes” apo “rrethanat e çështjes / pretendimet e palëve”, duke i parashtruar ato përgjithësisht në mënyrë të qartë, në një rend logjik dhe kronologjik, dhe duke integruar në disa raste në përmbajtje të faktit, provat përkatëse të analizuara në raport me njëra tjetrën. Një analizë e tillë konstatohet tek çështjet penale. Nga përmbajtja e këtyre vendimeve, konstatohet se

---

<sup>1</sup> Thuajse në të gjitha vendimet gjyqtari ka marrë në shqyrtim kompetencën dhe juridiksionin përveç se në vendimin nr. 665-3339, datë 05.04.2018 dhe vendimin nr. 1211-323, datë 15.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>2</sup>Në vendimet penale themeli.

<sup>3</sup> Vendimi nr.37- 12, datë 10.01.2019; vendimi nr.208-53, datë 22.02.2019; vendimi nr/876-230, datë 08.07.2019, vendimi nr.1170-159, datë 08.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

përshkrimi dhe analiza e rrethanave të çështjes bëhet kryesisht sipas përshkrimit të bërë nga organi procedues/ prokurori, duke pasqyruar në disa raste edhe qëndrimin e organit të akuzës, për bazueshmërinë e kërkesës së paraqitur apo se nga provat provohet fajësia e të pandehurit.

Ndërsa në çështjet familjare, konstatohet se gjyqtari paraqet në mënyrë tepër të përmbledhur rrethanat e faktit, në nëndarjen e saj, duke përshkruar vetëm faktin që ka të bëjë me lidhjen e martesës dhe faktin se nga martesa kanë lindur fëmijë (në ato raste kur bashkëshortët kanë fëmijë), pa përshkruar këtu faktet që lidhen me fëmijët, apo ato që kanë rezultuar nga pohimet gjyqësore, të cilat më pas përshkruhen dhe analizohen në mënyrë tepër të përmbledhur tek nëndarja “vlerësimi i gjykatës”. Në pjesën e titulluar “Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se”, gjyqtari përshkruan edhe procedurën e ndjekur nga gjyqtari për kryerjen e seancës së pajtimit, si dhe analizën se përse vlerësohet se nuk ka mundësi për pajtim, apo faktin se pse gjykata nuk vlerëson se nuk jemi në kushtet e shtyrjes së shpalljes së vendimit sipas nenit 136 të K.Penal.

Ndërsa në çështjet civile themeli, apo në çështjet civile pa palë kundërshtare konstatohet se gjyqtari në pjesën e parë të pjesës arsyetuese të vendimit, megjithëse në disa raste kjo pjesë titullohet “rrethanat e faktit”, “rrethanat e faktit të pretenduar nga paditësi” apo “gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi e provuar se” nuk përshkruan rrethanat e çështjes siç kanë rezultuar nga shqyrtimi gjyqësor, duke i shoqëruar me evidentimin, referimin dhe analizën e provave të administruara në gjykim. Gjyqtari paraqet rrethanat dhe faktet, ashtu siç janë pretenduar nga pala paditëse, si dhe pretendimet e kësaj pale lidhur me mbështetjen e këtyre pretendimeve në ligj dhe në prova si dhe përshkrimin e tyre sipas prapsimeve të palës së paditur. Pra gjyqtari në këto vendime pasqyron vetëm pretendimet e palëve në mënyrë të detajuar, si në lidhje me përshkrimin e rrethanave dhe faktit ashtu dhe në lidhje me bazueshmërinë në ligj ose jo të kërtimeve të tyre, çka e bën të paqartë vendimin në këtë pjesë të tij. Më pas disa rrethana të vlerësuara të rëndësishme nga gjyqtari, analizohen në pjesën “vlerësimi të gjykatës” lidhur me bazueshmërinë e tyre në ligj.

**- Lidhur me identifikimin e natyrës së çështjes.**

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i fakteve të çështjes, gjyqtari përgjithësisht përcakton natyrën e marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, familjare apo penale. Thuajse në të gjitha vendimet civile burim vlerësimi, gjyqtari identifikon dhe përcakton qartë natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, menjëherë pas paraqitjes së rrethanave procedurale dhe analizës së faktit. Në çështjet penale, natyra e çështjes rezulton e qartë nga objekti i çështjes dhe identifikohet në pjesën e parë të arsyetimit të vendimit, referuar specifikave të çështjeve konkrete, siç janë rastet e çështjeve të seancës paraprake, në të cilat objekti i shqyrtimit rezulton të përcaktohet që në pjesën hyrëse të arsyetimit, duke orientuar edhe natyrën e procedimit të zhvilluar, si dhe faktet që do të jenë objekt vlerësimi në vijim të arsyetimit. Po ashtu në çështjet penale, identifikimi i natyrës së çështjes objekt shqyrtimi i shërben orientimit të arsyetimit të vendimit, duke reflektuar specifikat e çështjeve penale të themelit dhe atyre të seancës paraprake, në funksion të organizimit të analizës ligjore të çështjes.

Pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, gjyqtari përgjithësisht përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*nëse jemi para përmbushje detyrimi kontraktor; pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv; kthim prone; revokim kontrate dhurimi; lëshim urdhër ekzekutimi, vërtetim fakti; rivendosje në afat etj.*), institutin përkatës në çështjet familjare (*instituti i martesës, zgjidhja dhe pasojat që rrjedhin prej saj*), si dhe llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri në çështjet penale apo natyrën e kërkesës penale (*vjedhje; drejtim të automjeteve në mënyrë të parregullt; mosdhënie mjete për jetesë, ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit, mospagimi i tatimeve dhe taksave, sigurim i kushteve dhe i mjeteve për kryerjen për të kryer vrasje etj.*)

Nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtari dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që natyra juridike e çështjes jo gjithmonë është identifikuar në mënyrë specifike, por del qartë në shumicën e vendimeve referuar identifikimit të elementeve dhe kriterëve ligjore të mosmarrëveshjes juridike në vendimet gjyqësor burim vlerësimi.

#### **- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm**

Përcaktimi i saktë natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjeve, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari përgjithësisht identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi.

Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (*i*) vendime civile/familjare dhe (*ii*) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e kërkesave apo situatave procedurale, konstatohet se:

#### **Sa i përket ligjit procedural:**

Në vendimet civile (*zgjidhje martese, përmbushje detyrimi kontraktor; pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv; kthim prone; revokim kontrate dhurimi; lëshim urdhër ekzekutimi, vërtetim fakti; rivendosje në afat etj.*), gjyqtari identifikon dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenet 35/3, 36/1, 41, 42, 48, 53, 59 si dhe nenin 511<sup>4</sup> të K. Pr, Civile në lidhje me juridiksionin, kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve, referuar objektit të tyre (*çështje me objekt zgjidhje martese, përmbushje detyrimi kontraktor; pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv; kthim prone; revokim kontrate dhurimi; lëshim urdhër ekzekutimi, vërtetim fakti; rivendosje në afat etj*)<sup>5</sup>;
- nenin 12 dhe 213 të K.Pr.Civile në lidhje me barrën e provës në procesin civil<sup>6</sup>;

---

<sup>4</sup> Vendimi nr. 55-19 vendimi, datë vendimi 20.01.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>5</sup> Në të gjitha vendimet civile

<sup>6</sup> Vendimi nr. 1224-380, datë 17.10.2019 dhe Vendimi nr. 1846-291, datë 19.09.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

- nenin 31 të K. Pr. Civil në lidhje me të drejtën e padisë<sup>7</sup>,
- nenin 35 të K.Pr.Civile në lidhje me përbërjen e trupit gjykues<sup>8</sup> ;
- nenet 55, 189 dhe 190 në lidhje me ndërhyrjen kryesore dhe bashkimin e saj me kërkesëpadinë<sup>9</sup> ;
- nenin 102 dhe 106 të K. Pr. Civil në lidhje me shpenzimet gjyqësore<sup>10</sup> ;
- nenin 158/a në lidhje me zhvillimin e seancës përgatitore<sup>11</sup> ;
- nenet 151-152 të K.Pr.Civile në lidhje me kërkesën për rivendosje në afat<sup>12</sup> ;
- nenin 388 të K.Pr.Civile në lidhje me regjimin juridik të “vërtetimit gjyqësor të faktëve juridike”<sup>13</sup> ;
- nenet 126 dhe 309 të K.Pr.Civile në lidhje me vendimin përfundimtar të gjykatës<sup>14</sup> ;
- nenin 227 të K.Pr.Civile në lidhje me caktimin e detyrave ekspertit<sup>15</sup>
- nenin 510 të K.Pr.Civile në lidhje me titujt ekzekutivë<sup>16</sup> ;
- nenin 609 të K.Pr.Civile në lidhje me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv<sup>17</sup>

**Në çështjet penale**, referuar natyrës së çështjes (*çështje penale e fazës së hetimit paraprak, seancës paraprake apo gjykim themeli*), apo ritit të gjykimit (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), gjyqtari identifikon dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenet nenet 69, 74, 76 të K.Pr.Penale në drejtim të vlerësimit të çështjeve të juridiksionit, kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtim<sup>18</sup>;
- nenin 13/3 të K.Pr.Penale në lidhje me përbërjen e trupit gjykues<sup>19</sup>;
- nenet 393/1 dhe 485/3 të K.Pr.Penale në lidhje me shpenzimet procedurale<sup>20</sup>;
- nenin 152 të K.Pr.Penale në lidhje me çmuarjen e provave<sup>21</sup> ;
- nenin 291 të K.Pr.Penale në lidhje me mosfillimin e procedimit<sup>22</sup> ;
- nenin 328 të K.Pr.Penale në lidhje me pushimin e akuzës/çështjes<sup>23</sup> ;
- nenin 403, 404, 405 dhe 406 të K.Pr.Penale në lidhje me gjykimin e shkurtuar<sup>24</sup>;

<sup>7</sup> Vendimi nr. 1224-380, datë 17.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>8</sup> Vendimi nr. 1224-380, datë 17.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>9</sup> Vendimi nr. 1224-380, datë 17.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>10</sup> Vendimi nr. 1224-380, datë 17.10.2019; Vendimi nr. 1657-372, datë 13.11.2017; Vendimi nr. 1096-318, datë 24.09.2019 dhe Vendimi nr. 1453-340, datë 25.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>11</sup> Vendimi nr. 1224-380, datë 17.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>12</sup> Vendimi nr. 665-339, datë 05.04.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>13</sup> Vendimi nr. 008-001, datë 08.01.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>14</sup> Vendimi nr. 55-19, datë 20.01.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>15</sup> Vendimi nr. 1264-196, datë 07.06.2018; Vendimi nr. 649-174, datë 20.04.2017; Vendimi nr. 1463-459, datë 16.12.2019; Vendimi nr. 361-111, datë 28.03.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>16</sup> Vendimi nr. 55-19, datë 20.01.2017 dhe Vendimi nr. 1657-372, datë 13.11.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>17</sup> Vendimi nr. 1657-372, datë 13.11.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>18</sup> Thuajse në të gjitha vendimet penale

<sup>19</sup> Vendimi nr. 509-64, datë 21.03.2017; Vendimi nr. 1170-159, datë 08.05.2019; Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>20</sup> Vendimi nr. 509-64, datë 21.03.2017; Vendimi nr. 1407-107, datë 19.06.2018; Vendimi nr. 2242-163, datë 25.10.2018; Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017; Vendimi nr. 673-84, datë 27.04.2017; Vendimi nr. 535-48, datë 23.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

<sup>21</sup> Vendimi nr. 509-64, datë 21.03.2017; Vendimi nr. 2242-163, datë 25.10.2018; Vendimi nr. 535-48, datë 23.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>22</sup> Vendimi nr. 1170-159, datë 08.05.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>23</sup> Vendimi nr. 1170-159, datë 08.05.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

- nenin 406/d-f të K.Pr.Penale në lidhje me gjykimin me marrëveshje <sup>25</sup>;
- nenet 38-39 të K.Pr.Penale në lidhje me rregullat për marrjen në pyetje të të pandehurit<sup>26</sup>;
- nenin 332 të K.Pr.Penale në lidhje me caktimin e seancës paraprake, nenet 332/a-gj të K.Pr.Penale në lidhje me mënyrën e zhvillimit të seancës paraprake, si dhe vendimin përkatës të gjyqtarit<sup>27</sup> ;
- nenin 362 të K.Pr.Penale në lidhje me kundërshtimin e dëshmisë, nenin 369 të K.Pr.Penale në lidhje me leximet e lejueshme, nenin 370 të K.Pr.Penale në lidhje me leximin e deklarimeve të bëra nga i pandehuri<sup>28</sup> ;
- nenin 290 të K.Pr.Penale në lidhje me rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit<sup>29</sup>; nenet 328 dhe 329 të K.Pr.Penale në lidhje me vendimin e prokurorisë për pushimin e akuzës ose çështjes dhe ankimin ndaj këtij vendimi, nenet 329/a dhe 329/b të K.Pr.Penale në lidhje me kërkesën për pushimin e akuzës ose çështjes dhe seancën paraprake për shqyrtimin e kësaj kërkesë<sup>30</sup>.

***Sa i përket ligjit material të zbatueshëm***, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se përgjithësisht gjyqtari identifikon dhe/ose citon dispozitat materiale të cilat gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori:(i) vendime civile/familjare dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, konstatohet se:

***Në vendimet civile***, gjyqtari identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar si dispozitave materiale të Kodit Civil dhe Kodit të Familjes, ashtu edhe ligjeve të posaçme apo akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, lidhur me:

- *Zgjidhjen e martesës dhe pasojat që rrjedhin prej saj*, gjyqtari identifikon dhe citon dispozitat ligjore familjare (nenet 2, 6, 132, 133, 134, 136, 145-162, 155, 157 dhe 210 të Kodit të Familjes) në lidhje me në lidhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës, në lidhje me përpjekjet për pajtim, në lidhje me praninë e psikologut në procedurat që kanë lidhje me të miturit, në lidhje me zgjidhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort, në lidhje me fajësinë, në lidhje me pasojat e zgjidhjes së martesës, në lidhje me pasojat e zgjidhjes së martesës ndërmjet bashkëshortëve, në lidhje me elementët që mban në

---

<sup>24</sup> Vendimi nr. 509-64, datë 21.03.2017; Vendimi nr. 1407-107, datë 19.06.2018; Vendimi nr. 2242-163, datë 25.10.2018; Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017; Vendimi nr. 673-84, datë 27.04.2017; Vendimi nr. 535-48, datë 23.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>25</sup> Vendimi nr. 1170-159, datë 08.05.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>26</sup> Vendimi nr. 1211-323, datë 15.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>27</sup> Vendimi nr. 1211-323, datë 15.10.2019; Vendimi nr. 37-12, datë 10.01.2019; Vendimi nr. 208-53, datë 22.02.2019; Vendimi nr. 876-230, datë 08.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>28</sup> Vendimi nr. 1211-323, datë 15.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

<sup>29</sup> Vendimi nr. 37-12, datë 10.01.2019; Vendimi nr. 208-53, datë 22.02.2019; Vendimi nr. 876-230, datë 08.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>30</sup> Vendimi nr. 37-12, datë 10.01.2019; Vendimi nr. 208-53, datë 22.02.2019; Vendimi nr. 876-230, datë 08.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

konsideratë gjykata në marrjen e vendimit për mënyrën e ushtrimit të përgjegjesisë prindërore, si në lidhje me detyrimin për ushqim<sup>31</sup>;

- *Përmbushjen e detyrimit kontraktor* gjyqtari identifikon nenet 419 të K. Civil në lidhje me kuptimin e marrëdhënies juridike të detyrimit, nenin 420 të K. Civil<sup>32</sup> në lidhje me burimet e detyrimeve, nenet 455, 476 dhe 698 të K. Civil në lidhje me përmbushjen e detyrimeve dhe pasojat e mospërmbushjes së tyre, nenin 450 të K. Civil në lidhje me kamatvonesat, nenin 690 të K. Civil në lidhje me fuqinë ligjore të kontratave<sup>33</sup>;
- *Revokimin e kontratës së dhurimit* gjyqtari identifikon nenin 769 të K. Civil në lidhje me garancinë që dhuruesi duhet t'i japë pranuesit në lidhje me përkatësinë e sendit të dhuruar, nenin 771 të K. Civil në lidhje me revokimin e dhurimit, si dhe nenet 192-214 të K. Familjes në lidhje me detyrimin për ushqim<sup>34</sup>;

Krahas dispozitave të Kodit Civil, Kodit të Familjes gjyqtari referon në ligje të posaçme të cilat gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes dhe në një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, duke identifikuar konkretisht:

- nenin 106 dhe nenin 109/3 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 "*Për komunikimet elektronike në RSH*" përkatësisht në lidhje me faturën burim detyrimi dhe mospërmbushjen e detyrimeve nga pajtimtari, nenin 220/3 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" në lidhje me regjistrimin e bashkimit të shoqërive tregtare, si dhe kontratën e pajtimit<sup>35</sup>
- nenin 6 dhe 8 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 "*Për komunikimet elektronike në RSH*" në lidhje me AKEP, nenin 106 dhe nenin 109/3 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 "*Për komunikimet elektronike në RSH*" përkatësisht në lidhje me faturën burim detyrimi dhe mospërmbushjen e detyrimeve nga pajtimtari, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", si dhe kontratën e pajtimit<sup>36</sup>;
- ligjin nr. 8662, datë 18.09.2000 "*Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike*" të ndryshuar, nenin 51 të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 "*Për sektorin e energjisë elektrike*" në lidhje me matjen e energjisë elektrike të furnizuar, Vendimin nr. 42, datë 22.04.2011 të ERE<sup>37</sup>;
- ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 "*Për kthimin dhe kompensimin e pronës*" përkatësisht nenet 2 dhe 6 në lidhje me subjektet e legjitimuar, ligjin nr. 133, datë 05.12.2015 "*Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave*", përkatësisht nenin 3 në lidhje me fushën e zbatimit të tij, si dhe ligjin nr. 108, datë 29.08.1945 "*Për reformën agrare*"<sup>38</sup>;

---

<sup>31</sup> Vendimi nr. 1264-196, datë 07.06.2018; Vendimi nr. 649-174, datë 20.04.2017; Vendimi nr. 1463-459, datë 16.12.2019; Vendimi nr. 361-111, datë 28.03.2019; Vendimi nr. 578-178, datë 10.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>32</sup> Vendimi nr. 71-16, datë 22.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>33</sup> Vendimi nr. 1453-340, datë 25.10.2017; Vendimi nr. 1096-318, datë 24.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>34</sup> Vendimi nr. 1224-380, datë 17.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>35</sup> Vendimi nr. 1453-340, datë 25.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

<sup>36</sup> Vendimi nr. 1096-318, datë 24.09.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>37</sup> Vendimi nr. 1657-372, datë 13.11.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>38</sup> Vendimi nr. 1846-291, datë 19.09.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.



- nenin 1 të ligjit nr. 8662, datë 18.09.2000 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike” të ndryshuar në lidhje me faturën tatimore të energjisë elektrike si titull ekzekutiv, nenin 36 të ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” në lidhje me elementët që duhet të përmbajë fatura tatimore sipas modelit të miratuar nga Ministria e Financave, si dhe vendimin nr. 108, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve familjare” miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.03.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s<sup>39</sup>;
- nenin 27 të ligjit nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës” në lidhje me afatin për aplikim për njohjen e pronësisë<sup>40</sup>.

**Në vendimet penale**, gjyqtari identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, si edhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal në funksion të analizës së instituteve dhe parimeve të zbatueshme, si më poshtë:

- nenin nenin 1/b të K. Penal në lidhje me detyrat e legjislacionit penal, nenin 1/c të K. Penal në lidhje me parimet e K. Penal <sup>41</sup>;
- nenin 4 të K. Penal në lidhje parashikimin se mosnjohja e ligjit nuk përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia penale <sup>42</sup>;
- nenin 25 të K. Penal në lidhje me bashkëpunimin <sup>43</sup>;
- nenin 47 të K. Penal në lidhje me mënyrën e caktimit të dënimit<sup>44</sup> ;
- neni 48 të K. Penal në lidhje me rrethanat lehtësuese <sup>45</sup> dhe nenin 50 të K. Penal në lidhje me rrethanat rënduese <sup>46</sup> ;
- nenin 59 të K. Penal në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe venien në provë<sup>47</sup> ;
- nenin 66 të K. Penal në lidhje me parashkrimin e ndjekjes penale<sup>48</sup>;
- nenin 130/a/4 të K. Penal në lidhje me veprën penale “*Dhuna në familje*”<sup>49</sup> ;
- nenin 134/1 të K. Penal në lidhje me veprën penale “*Vjedhja*”<sup>50</sup> ;
- nenin 141/a të K. Penal në lidhje me veprën penale “*Trafikimi i mjeteve motorrike*”<sup>51</sup>

<sup>39</sup> Vendimi nr. 55-19, datë 20.01.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>40</sup> Vendimi nr. 665-339, datë 05.04.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>41</sup> Vendimi nr. 509-64, datë 21.03.2017; Vendimi nr. 1407-107, datë 19.06.2018; Vendimi nr. 2242-163, datë 25.10.2018; Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017; Vendimi nr. 673-84, datë 27.04.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>42</sup> Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>43</sup> Vendimi nr. 1211-323, datë 15.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>44</sup> Vendimi nr. 509-64, datë 21.03.2017; Vendimi nr. 2242-163, datë 25.10.2018; Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017; Vendimi nr. 673-84, datë 27.04.2017; Vendimi nr. 535-48, datë 23.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>45</sup> Vendimi nr. 673-84, datë 27.04.2017; Vendimi nr. 535-48, datë 23.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>46</sup> Vendimi nr. 535-48, datë 23.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>47</sup> Vendimi nr. 1407-107, datë 19.06.2018; Vendimi nr. 1170-159, datë 08.05.2019; Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>48</sup> Vendimi nr. 37-12, datë 10.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>49</sup> Vendimi nr. 535-48, datë 23.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>50</sup> Vendimi nr. 509-64, datë 21.03.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>51</sup> Vendimi nr. 37-12, datë 10.01.2019; Vendimi nr. 208-53, datë 22.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

- nenin 186/1 të K. Penal në lidhje me veprën penale “*Falsifikimi i dokumentave*”<sup>52</sup> ;
- nenin 199/a/2 të K. Penal në lidhje me veprën penale “*Ndërtimi i paligjshëm*”,<sup>53</sup>
- nenet 186, 248 dhe 287 të K. Penal në lidhje me veprat penale përkatësisht “*Falsifikimi*”, “*Shpërdorimi i detyrës*” dhe “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”<sup>54</sup>;
- nenin 236/2 të K. Penal në lidhje me veprën penale “*Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik*”<sup>55</sup> ;
- nenin 278 të K. Penal në lidhje me veprën penale “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*”<sup>56</sup> ;
- nenin 290 të K. Penal në lidhje me veprën penale “*Shkleja e rregullave të qarkullimit rrugor*”<sup>57</sup>;
- nenin 321/2 të K. Penal në lidhje me veprën penale “*Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës*”<sup>58</sup>.

Krahas dispozitave të Kodit Penal, gjyqtari ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm, një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës si dhe një sërë ligjesh të posaçme në drejtim të vlerësimit të anës objektive të veprave penale specifike, dhe konkretisht:

- nenin nenin 17 të Kushtetutës në lidhje me parimin e proporcionalitetit<sup>59</sup>;
- nenin 42/2 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ në lidhje me parimin e gjykatës së caktuar me ligj<sup>60</sup>;
- nenin 53 të Kushtetutës në lidhje me mbrojtjen e veçantë që gëzon familja<sup>61</sup>;
- nenin 148 të Kushtetutës në lidhje me funksionin e prokurorisë<sup>62</sup>;
- ligjin nr. 107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, përkatësisht nenin 2 në lidhje me parimet bazë të ligjit, nenin 3 në lidhje me përkufizime të termave të caktuara, nenin 39 në lidhje me lejen e ndërtimit, nenin 41 në lidhje me rastet që nuk kërkohet pajisja me leje ndërtimi, neni 42 në lidhje me çertifikatën e përdorimit, si dhe Rekomandimin nr. R (99) 22 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare në lidhje me mbipopullimin e burgjeve<sup>63</sup>.

**Sa i përket konfliktit të normave**, vetëm në vendimin nr. 1211-323, datë 15.10.2019, me objekt «*Dërgimin e çështjes në gjyq dhe pushimin e pjesshëm të hetimeve* » gjyqtari vlerëson se ka një konflikt mes nenit 332 pikat 1 dhe 2 dhe nenit 332/a pika 3 të K.Pr.Penale sa i takon

<sup>52</sup> Vendimi nr. 1170-159, datë 08.05.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>53</sup> Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>54</sup> Vendimi nr. 1211-323, datë 15.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>55</sup> Vendimi nr. 2242-163, datë 25.10.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>56</sup> Vendimi nr. 673-84, datë 27.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>57</sup> Vendimi nr. 876-230, datë 08.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>58</sup> Vendimi nr. 1407-107, datë 19.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>59</sup> Vendimi nr. 509-64, datë 21.03.2017; Vendimi nr. 2242-163, datë 25.10.2018; Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017; Vendimi nr. 673-84, datë 27.04.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>60</sup> Vendimi nr. 1170-159, datë 08.05.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>61</sup> Vendimi nr. 535-48, datë 23.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>62</sup> Vendimi nr. 37-12, datë 10.01.2019; Vendimi nr. 208-53, datë 22.02.2019; Vendimi nr. 876-230, datë 08.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>63</sup> Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

çaktimit të seancës paraprake. Për zgjidhjen e këtij konflikti, gjyqtari referon vendimin nr. 4, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me detyrimin e gjykatës që të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese.

Gjyqtari e ka vlerësuar aftësinë e tij për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave në shkallë shumë të lartë duke theksuar se *“Gjatë periudhës së vlerësimit kam gjykuar dhe dhënë vendime nga data 01.01.2017-31.12.2019 2013 çështje, çështje të natyrave të ndryshme si: penale, civile, familjare etj. Pra, kam përballuar një ngarkesë shumë të lartë dhe duhet të vë në dukje se çështjet e mbartura për vitin pasardhës kanë qenë në numër jo të konsiderueshëm. Secilës çështje i kam kushtuar kohën dhe vëmendjen e duhur dhe vlerësoj se kam patur aftësinë për të përcaktuar lehtë faktet, identifikuar natyrën e çështjes, ligjin që duhet zbatuar etj. Pavarësisht gjykimit të një numri të lartë çështjesh, gjykatat më të larta në asnjë rast nuk kanë çmuar se përcaktimi i fakteve etj. është i ndryshëm nga ai që është bërë nga unë si dhe kam vlerësuar ligjin e zbatueshëm dhe probleme të tij, konflikte të normave apo ndryshime të ligjit në raport me juridiksionin apo kompetencën lëndore, funksionale apo tokësore të gjykatës, duke marrë vendimet përkatëse të ndërmjetme dhe në vijim zgjidhjen e çështjes me vendimin përfundimtar.”*.

## **KONKLuzioni**

*Në tërësi*, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton aftësia e gjyqtarit për paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve, si atyre me natyrë procedurale, në të cilat jep një panoramë të qartë të ecures së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore në rastet kur elementët procedurale lidhen në trajtimin e kërkesave të palëve apo elementë procedurale të vlerësuar kryesisht nga gjykata, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes, kryesisht në çështjet penale, të cilat përgjithësisht paraqiten në mënyrë të përmbledhur, duke i integruar në disa raste dhe provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës. Por edhe në këtë rast faktet dhe rrethanat përshkruhen ashtu siç janë paraqitur nga organi procedues. Ndërsa në vendimet civile rezulton se gjyqtari nuk përshkruan dhe analizon faktet e çështjet siç kanë rezultuar nga gjykimi, por ato pasqyrohen në vendim, vetëm sipas përshkrimit dhe analizës që i ka bërë secila palë fakteve të çështjes në mbështetje të pretendimeve të tyre, duke mos dhënë kështu gjithmonë një panoramë të qartë të fakteve që kanë rezultuar nga shqyrtimi gjyqësor. Ndërsa rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e saj.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “mbi mesatare” dhe pikëzohet me 20 pikë.

### ***1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.***

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përgjithësisht bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore përmenden ose citohen duke u shoqëruar përgjithësisht me interpretimin e tyre abstrakt dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Por konstatohet se në një pjesë të vendimeve, interpretimi abstrakt zë pjesën më të madhe të vendimit, ndërsa aplikimi i tij mbi faktet e çështjes, pra si ligji gjen zbatim në raport me rrethanat dhe faktet e çështjes paraqitet tepër i përmbledhur dhe në disa raste mungon një arsyetim i tillë<sup>64</sup>, duke konkluduar direkt në përfundimet për zgjidhjen e çështjes. Gjyqtari, në disa vendime burim vlerësimit, citimin ose referimin në dispozita e shoqëron me interpretimin të tyre në mënyrë të abstrakte, para aplikimit mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur. Por nuk i kushton të njëjtën rëndësi arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, të cilat jo gjithmonë shoqërohen me interpretim të ligjit konkret, apo me interpretimin e normave në funksion të rrethanave të çështjes sidomos tek shqyrtimi i kërkesave penale me objekt – dërgim çështjesh në gjykim apo pushim gjykimi, apo në çështjen penale, gjykim me marrëveshje, ku gjyqtari nuk citon dhe analizon se si ligji gjen zbatim në raport me faktet konkrete si dhe aktet provuese. Një interpretim i tillë konstatohet edhe tek çështjet familjare me objekt zgjidhje martesë, ku gjyqtari tejzgjatet në interpretimin abstrakt të ligjit, apo të natyrës së marrëdhënies së posaçme të martesës dhe të pasojave të zgjidhjes së saj, e cila zë dhe pjesën më të madhe të vendimit, duke u ndalur shkurtimisht në interpretimin e ligjit në raport me rrethanat e çështjes ku në disa raste mungon një analizë e tillë, por mjaftohet vetëm me dhënien e konkluzioneve përkatëse.

#### ***- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:***

<sup>64</sup> Vendimi nr.1846-291, datë 19.09.2018, vendimi nr.71-16, datë 20.01.2019, vendimi nr.1096- 318, datë 24.09.2019, vendimi nr.1224-380, datë 17.10.2019; vendimi penal me nr.1170-159, datë 08.10.2019, vendimi nr.1211-323, datë 15.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

*Në vendimet civile* përgjithësisht interpretimi i normës bëhet duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete. Ndërsa analiza e normës në raport me faktin që ka rezultuar në gjykim, paraqitet tepër i përmbledhur dhe në disa raste mungon një interpretim i tillë. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtari :

- Analizon marrëdhënien juridike të detyrimit rrjedhur nga kontrata e pajtimit të shërbimit telefonik, duke u ndalur në natyrën dhe kushtet e përmbajtjes së saj. Gjithashtu, merr në analizë faturën telefonike të lëshuar në kuadër të kontratës së pajtimit të shërbimit telefonik, si dhe vlerën e saj në aspektin e së drejtës materiale dhe procedurale<sup>65</sup> ;
- Analizon natyrën e vendimeve të ish-KKKP duke iu referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe asaj unifikuese të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, shtron për diskutim dhe trajton ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi duke u nisur nga fakti se gjatë gjykimit të saj ka hyrë në fuqi ligji i ri për trajtimin e ish-pronarëve. Për këtë qëllim, ndalet në analizën e veprimit të ligjit në kohë dhe pasi përcakton ligjin e zbatueshëm, evidenton kriteret përkatëse për efekt të përfitimit prej tij të subjekteve të shpronësuara. Gjithashtu trajton konceptin e shkakut ligjor të padisë<sup>66</sup> ;
- Analizon revokimin e dhurimit referuar nenit 771 të K. Civil. Në këtë kuadër, duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën shqiptare dhe atë të huaj (*pa e cituar përkatësisht*) trajton rastet kur mund të kërkohet revokimi i dhurimit, si dhe shkaqet ligjore të cilat e legjitimojnë atë.<sup>67</sup> ;
- Analizon parimin procedural të barrës së provës së procesin civil<sup>68</sup> dhe parimin e sigurisë juridike dhe parimin e fuqisë prapavepruese të ligjit<sup>69</sup> ;
- Analizon titullin ekzekutiv si koncept juridik, duke sqaruar se ai përfaqëson aktin përfundimtar që përmban njohjen e detyrimit të plotë, të saktë, të përcaktuar të një personi apo subjekti kundrejt një tjetri sipas parashikimeve të ligjit. Gjithashtu, evidenton elementët që duhet të përmbajë titulli ekzekutiv për t'u cilësuar si i tillë, duke sjellë në vëmendje edhe vendimin unifikues nr. 13, datë 24.03.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë<sup>70</sup> ;
- Analizon kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “*Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*” për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes. Në këtë kuadër, sqaron se në gjykime të kësaj natyre, fillimisht verifikohet nëse palët ndërgjyqëse përfaqësojnë kategori të subjekteve të mbrojtura prej ligjit. Gjithashtu, sqaron konceptin e dhunës dhe format e saj, si dhe parimet që mbahen në konsideratë në kuadër të procesit të të provuarit referuar nenit 15/3 të ligjit. Gjithashtu analizon se në përcaktimin e tyre, duhet të mbahet në konsideratë së pari lloji, frekuenca dhe rrezikshmëria e akteve apo

---

<sup>65</sup> Vendimi nr. 1453-340, datë 25.10.2017; Vendimi nr. 1096-318, datë 24.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>66</sup> Vendimi nr. 1846-291, datë 19.09.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>67</sup> Vendimi nr. 1224-380, datë 17.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>68</sup> Vendimi nr. 1096-318, datë 24.09.2019; Vendimi nr. 1224-380, datë 17.10.2019; Vendimi nr. 1846-291, datë 19.09.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>69</sup> Vendimi nr. 1846-291, datë 19.09.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>70</sup> Vendimi nr. 55-19, datë 20.01.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

veprimeve të dhunës të të paditurit, së dyti, marrëdhëniet midis dhunuesit dhe viktimës dhe nevojat e kësaj të fundit, së treti, rrethin e personave afër viktimës që duhet të gëzojnë mbrojtje sëbashku me të dhe nevojat e këtyre personave<sup>71</sup> ;

- Në të pesë çështjet me objekt ‘‘Zgjidhje martesë’’ gjyqtari analizon :
  - i. martesën si institut juridik, duke evidentuar kuptimin dhe elementët thelbësore të saj. Në lidhje me këtë të fundit, evidenton konsensusin, si një element që duhet të ekzistojë jo vetëm në çastin e lidhjes së martesës, por përgjatë gjithë vazhdimësisë së saj;
  - ii. regjimin juridik të zgjidhjes së martesës, duke u ndalur veçanërisht në atë të parashikuar prej nenit 132 të K. Familjes *‘‘Zgjidhja e martesës me kërkesën e njërit bashkëshort’’*. Në kuadër të kësaj analize, evidenton dy kushte të cilat duhet të përmbushen në mënyrë kumulative: shkaku ligjor për të cilin kërkohet zgjidhja e martesës; pasoja e sjellë nga shkaku, kur martesë ka humbur qëllimin e saj dhe jetesa e përbashkët bashkëshortore është bërë e pamundur. Gjithashtu, evidenton se neni 132 i K. Familjes parashikon në mënyrë jo shterruese shkaqet e zgjidhjes së martesës, duke cilësuar si të tilla: grindjet e vazhdueshme, keqtrajtimet, fyerjet e rënda, shkeljen e besnikërisë bashkëshortore, sëmundjen mendore të pashërueshme, dënimin penal të rëndë të bashkëshortit ose çdo shkak tjetër që përbën shkelje të përsëritur të detyrimeve që rrjedhin nga martesë;
  - iii. pasojat e zgjidhjes së martesës në lidhje me bashkëshortët, duke u ndalur tek pushimi i së drejtës për të përdorur mbiemrin. Po kështu, trajton edhe pasojat e zgjidhjes së martesës në lidhje me fëmijët, në bazë të parimit të interesit më të lartë të të miturit, në tre aspekte: lënien e fëmijës për rritje dhe edukim; të drejtë e takimit për prindin tjetër; detyrimin për ushqim<sup>72</sup>.

***Në vendimet penale*** gjyqtari interpreton dispozitat e pjesës së posaçme dhe të përgjithshme të Kodit Penal në lidhje me cilësimin e veprës penale, elementët e saj (që përgjithësisht ndalet gjatë në interpretimin e tyre për çdo vepër penale në gjykim), moshën për përgjegjësi penale, bashkëpunimin, pezullimin e dënimit, dënimin alternativ etj. Më konkretisht gjyqtari:

- analizon veprën penale *‘‘Vjedhja’’* parashikuar përkatësisht nga neni 134/1 i K. Penal, duke u ndalur në objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive përkatëse si dhe trajton institutin e gjykimit të shkurtuar si gjykim i posaçëm, duke u ndalur në kuptimin dhe vlerat e aplikimit të tij<sup>73</sup> ;
- analizon veprën penale *‘‘Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës’’* parashikuar përkatësisht nga neni 321/2 i K. Penal, duke u ndalur në objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive përkatëse<sup>74</sup>;

---

<sup>71</sup> Vendimi nr. 407-125, datë 05.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>72</sup> Përveç se në vendimin nr. 578-178, datë 10.05.2019, ku bashkëshortët që kërkonin zgjidhjen e martesës nuk kishin fëmijë gjatë martesës.

<sup>73</sup> Vendimi nr. 509-64, datë 21.03.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>74</sup> Vendimi nr. 1407-107, datë 19.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

- analizon veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” parashikuar përkatësisht nga neni 236/2 i K. Penal, duke u ndalur në objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive përkatëse<sup>75</sup>;
- analizon veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm” parashikuar përkatësisht nga neni 199/a/2 i K. Penal, duke u ndalur në objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive përkatëse. Në këtë kuadër, i kushtohet vëmendje analizës së anës objektive dhe duke qënë se neni 199/a/2 i K. Penal cilësohet si një dispozitë blankete, referohet në parashikimet e ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”<sup>76</sup> ;
- analizon veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyeshe dhe i municionit” parashikuar përkatësisht nga neni 278/2 i K. Penal, duke u ndalur në objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive përkatëse<sup>77</sup> ;
- analizon veprën penale “Dhunë në familje” parashikuar përkatësisht nga neni 130/a/4 i K. Penal, duke u ndalur në objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive përkatëse<sup>78</sup> ;
- trajton institutin e dënimit penal, kuptimin, funksionin dhe parimet e caktimit të tij, si dhe elementët që duhet të mbahen në konsideratë në caktimin e masës së tij referuar nenit 47 të K. Penal<sup>79</sup> ;
- trajton institutin e “Gjykimit me marrëveshje”, duke u ndalur në kuptimin dhe qëllimet e tij, si dhe identifikon kushtet ligjore të nevojshme për aplikimin e tij, përkatësisht kushtet pozitive dhe kushte penguese, duke u ndalur në evidentimin dhe analizën e tyre. Gjithashtu kushtet pozitive dhe kushtet penguese të “Gjykimit me marrëveshje” mbi faktet konkrete të çështjes<sup>80</sup> . Por siç u tha më sipër, në këtë rast mungon analiza e ligjit në raport me rrethanat e çështjes, pra si rrethanat e çështjes gjejnë zbatim në rastin konkret.
- Analizon alternativën e dënimit me burgim parashikuar nga neni 59 i K. Penal, duke trajtuar kushtet e aplikimit<sup>81</sup>.

**Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale** civile dhe penale, gjyqtari përgjithësisht i jep rëndësi interpretimit të normës së zbatueshme si në rastet kur trajtohen çështje të procedurës, ashtu edhe në rastet kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel, si p.sh çështjet penale të seancës paraprake. Konkretisht:

- Analizon padinë për kundërshtimin e titullit ekzekutiv sipas nenit 609 të K.Pr.Civile. Në këtë kuadër, trajton kuptimin e kësaj padie, si dhe shkaqet që legjitimojnë ngritjen e saj, duke evidentuar si të tilla paligjshmëritë në objekt, paligjshmëritë në subjekt apo në

<sup>75</sup> Vendimi nr. 2242-163, datë 25.10.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>76</sup> Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>77</sup> Vendimi nr. 673-84, datë 27.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>78</sup> Vendimi nr. 535-48, datë 23.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>79</sup> Vendimi nr. 509-64, datë 21.03.2017; Vendimi nr. 2242-163, datë 25.10.2018; Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017; Vendimi nr. 673-84, datë 27.04.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>80</sup> Vendimi nr. 1170-159, datë 08.05.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>81</sup> Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

përmbajtje ; si dhe trajton elementët që duhet të përmbajë faturë e energjisë elektrike titull ekzekutiv<sup>82</sup> ;

- Analizon regjimin juridik të “Vërtetimit gjyqësor të fakteve juridike”, referuar nenit 388 të K.Pr.Civile. Në interpretim të kësaj dispozite, sqaron se në mënyrë që gjykata të shqyrtojë kërkesën për vërtetimin e faktit juridik, duhet të ekzistojnë dy kushte: së pari, që fakti i kërkuar për vërtetim, nëse ka ekzistuar, ka përfaqësuar një fakt prej të cilit rrjedhin pasoja juridike (lindje, ndryshim ose shuarje e të drejtave pasurore apo personale); së dyti, që akti i duhur për vërtetimin e këtij fakti juridik, të mos ketë mundësi të merret në rrugë tjetër ose kur ai është marrë më përpara, ka humbur apo është zhdukur dhe nuk mund të merret përsëri në rrugën që u mor<sup>83</sup> ;
- Në çështjen me objekt “Dërgim i çështjen në gjyq”, gjyqtari merr në analizë nenin 332 pikat 1 dhe 2, si dhe nenin 332/a pika 3 të K.Pr.Penale, të cilat krijojnë konflikt me njëra tjetrën sa i takon caktimit të seancës paraprake. Në këtë kuadër, sjell në vëmendje edhe vendimin nr. 4, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me detyrimin e gjykatës që të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese<sup>84</sup>.
- Në çështjen civile që i përket vendimit nr.1224-380, datë 17.10.2019, rezulton se gjatë gjykimit gjyqtari ka pranuar kërkesën i ndërhyrësit kryesor për të ndërhyrë në gjykim, me padinë e tij, duke cituar nenin 189, 190 dhe 55 të K.Pr.Civile (shih përmbajtjen e vendimit), por pa bërë një interpretim të tyre, si një analizë të kësaj vendimarrje të gjykatës, në lidhje me momentin procedural se kur një kërkesë e tillë paraqitet në gjykatë e pranohet nga gjykata, që sipas dispozitave të mësipërme mund të pranohet deri sa nuk është nxjerrë urdhëri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Në dosjen gjyqësore që i përket këtij vendimi ndodhet edhe vendimi i ndërmjetëm i gjykatës për «bashkimin e çështjes », ku gjyqtari ka referuar nenin 57 të KPRC, përpara ndryshimeve të bëra me ligjin nr.38/2017, duke mos bërë kështu referimin e saktë të ligjit të zbatueshëm në fuqi në kohën e shqyrtimit të padisë<sup>85</sup>. Gjyqtari analizon rastin e bashkimit të dy çështjeve të regjistruara më vetem që kanë lidhje mes tyre për nga objekti, duke referuar faktin se janë familjare, si dhe ka të bëjë me të njëjtin rast gjykimi, por pa referuar dhe arsyetuar se si gjen zbatim dhe aplikohet në rastin konkret neni 189 dhe 190 të KPRC, në lidhje me nenin 57 të KPRC, në kushtet kur gjyqtari ka pranuar për shqyrtim kërkesën e ndërhyrësit kryesor për të ndërhyrë në gjykim dhe më pas ka bërë edhe një vendim për bashkimin e çështjes.

***Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante***, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës*

---

<sup>82</sup> Vendimi nr. 1657-372, datë 13.11.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>83</sup> Vendimi nr. 008-001, datë 08.01.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>84</sup> Vendimi nr. 1211-323, datë 15.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>85</sup> Neni 57 i KPRC, i ndryshuar me ligjin nr.38/2017, parashikon se;”1. Kur dy ose më shumë padi janë duke u gjykuar në procese të ndryshme dhe lidhen midis tyre për nga objekti ose shkaku, mund të bashkohen në një gjykim të vetëm.

2. Vendimin për bashkimin e çështjeve e merr gjykata në të cilën çështja është regjistruar më parë në kohë.

3. Bashkimi i çështjeve mundet të bëhet me kërkesë të palëve ose kryesisht, derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore nga gjykata që merr vendimin....”



së Lartë, vendimet e Kolegjit Civil dhe Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ), në mbështetje të argumenteve të tij në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- Referon vendimin nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht në lidhje me gjykimin e shkurtuar<sup>86</sup>;
- Referon vendimin nr. 1, datë 12.01.2011 dhe nr. 19, datë 01.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me dënimin penal<sup>87</sup>;
- Referon vendimin unifikues nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me gjykimin e shkurtuar<sup>88</sup>;
- Referon vendimin nr. 28, datë 26.01.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në lidhje me aplikimin e alternativave të dënimit me burgim<sup>89</sup>;
- Referon vendimet nr. 12, datë 18.05.2005, nr. 14, datë 17.04.2007, nr. 11, datë 23.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me gjykatën “e krijuar me ligj”<sup>90</sup>;
- Referon vendimin nr. 3 datë 06.02.2008 në lidhje me funksionet e prokurorisë, vendimin nr. 14, datë 16.07.2008 në lidhje me kontrollin gjyqësor të vendimmarrjes së prokurorisë, si dhe vendimin nr. 5, datë 06.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me kontrollin gjyqësor të veprimeve gjatë hetimeve paraprake<sup>91</sup>;
- Referon vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimin nr. 137, datë 26.10.2011 të në lidhje me pasojat e mosushtrimit të ligjshëm të ndjekjes penale, vendimin nr. 196, datë 04.07.2012 dhe nr. 7, datë 16.01.2013 në lidhje me kontrollin gjyqësor të veprimeve hetimore të prokurorisë<sup>92</sup>;
- Referon vendimin unifikues nr. 3, datë 29.03.2012 të Gjykatës së Lartë në lidhje me konceptin e shkakut ligjor të padisë<sup>93</sup>;
- Referon vendimin nr. 4, datë 08.04.1994, vendimin nr. 30, datë 01.12.2005, vendimin nr. 9, datë 26.02.2007, vendimin nr. 33, datë 24.06.2010, si dhe vendimin nr. 27/2010 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave si dhe natyrën e vendimeve të ish-KKKP<sup>94</sup>;
- Referon vendimet e Gjykatës së Lartë përkatësisht vendimin nr. 4/2013 në lidhje me kompetencën per gjykimin e mosmarrëveshjeve qe lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave, vendimin nr. 3/2012 në lidhje me shkakun ligjor të padisë<sup>95</sup>,

---

<sup>86</sup> Vendimi nr. 509-64, datë 21.03.2017; Vendimi nr. 2242-163, datë 25.10.2018; Vendimi nr. 1407-107, datë 19.06.2018; Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017; Vendimi nr. 673-84, datë 27.04.2017; Vendimi nr. 535-48, datë 23.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>87</sup> Vendimi nr. 2242-163, datë 25.10.2018; Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017; Vendimi nr. 673-84, datë 27.04.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>88</sup> Vendimi nr. 509-64, datë 21.03.2017; Vendimi nr. 2242-163, datë 25.10.2018; Vendimi nr. 1407-107, datë 19.06.2018; Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017; Vendimi nr. 673-84, datë 27.04.2017; Vendimi nr. 535-48, datë 23.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>89</sup> Vendimi nr. 1407-107, datë 19.06.2018; Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>90</sup> Vendimi nr. 1170-159, datë 08.05.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>91</sup> Vendimi nr. 37-12, datë 10.01.2019; Vendimi nr. 208-53, datë 22.02.2019; Vendimi nr. 876-230, datë 08.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>92</sup> Vendimi nr. 37-12, datë 10.01.2019; Vendimi nr. 208-53, datë 22.02.2019; Vendimi nr. 876-230, datë 08.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>93</sup> Vendimi nr. 1846-291, datë 19.09.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>94</sup> Vendimi nr. 1846-291, datë 19.09.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>95</sup> Vendimi nr. 1846-291, datë 19.09.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

- Referon vendimet e Gjykatës së Lartë përkatësisht vendimin nr. 3, datë 03.02.2006 në lidhje me kontratën e dhurimit<sup>96</sup> ;
- Referon vendimin unifikues nr. 13, datë 24.03.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje elementët që duhet të përmbajë titulli ekzekutiv për t'u cilësuar si i tillë<sup>97</sup> ;
- Referon vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimin nr. 980, datë 29.09.2000 dhe vendimin nr. 13, datë 24.03.2004 në lidhje me titullin ekzekutiv, si dhe vendimin nr. 3 datë 29.03.2012 në lidhje me objektin dhe shkakun e padisë<sup>98</sup> ;
- Referon vendimin nr. 427, datë 11.11.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në lidhje me rolin e gjykatës në gjykime me objekt lëshimin e urdhrin të ekzekutimit<sup>99</sup> ;
- Referon vendimin nr. 650, datë 11.12.2014 të Gjykatës së Lartë në lidhje me natyrën e gjykimeve për vërtetimin gjyqësor të fakteve<sup>100</sup>.

Por në vendimin nr.1224-380, datë 17.10.2019, gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur si referencë dy vendime unifikues të Gjykatës së Lartë, që kanë lidhje me pavlefshmërinë e veprimeve juridike, përkatësisht vendimin nr.13, datë 09.03.2006 si dhe vendimin nr. 3, datë 03.02.2006 të cilat konstatohet se nuk janë përdorur nga gjyqtari për të mbështetur argumentimin e tij në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe as nuk rezultojnë se kanë lidhje me çështjes, përse kohë që çështja ka për objekt revokimin e kontratës dhurimit dhe jo pavlefshmërinë e saj. Gjithashtu, nuk konstatohet se gjyqtari ka arsyetuar kryesisht lidhur me pavlefshmërinë e këtij veprimi juridik.

***Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës,*** nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i gjyqtarit që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet duke i përmendur ato shprehimisht apo të nxjerra nga konteksti i arsyetimit të vendimit. Gjyqtari njeh, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- Parimin procedural të vlerësimit të provave në harmoni me njëra-tjetrën referuar nenit 152 të K. Pr. Penal<sup>101</sup>;
- Parimin e proporcionalitetit referuar nenit 17 të Kushtetutës<sup>102</sup>;
- Parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë para ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe dënimit dhe humanizmit<sup>103</sup> ;
- Parimin e së drejtës për mbrojtje efektive, të barazisë së armëve dhe të

<sup>96</sup> Vendimi nr. 1224-380, datë 17.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>97</sup> Vendimi nr. 55-19, datë 20.01.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>98</sup> Vendimi nr. 55-19, datë 20.01.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>99</sup> Vendimi nr. 55-19, datë 20.01.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>100</sup> Vendimi nr. 008-001, datë 08.01.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>101</sup> Vendimi nr. 509-64, datë 21.03.2017; Vendimi nr. 535-48, datë 23.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>102</sup> Vendimi nr. 509-64, datë 21.03.2017; Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017; Vendimi nr. 673-84, datë 27.04.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>103</sup> Vendimi nr. 509-64, datë 21.03.2017; Vendimi nr. 1407-107, datë 19.06.2018; Vendimi nr. 1311-163, datë 26.09.2017; Vendimi nr. 673-84, datë 27.04.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

kontradiktoritetit<sup>104</sup>;

- Parimin procedural të barrës së provës së procesin civil<sup>105</sup>;
- Parimin e sigurisë juridike dhe parimin e fuqisë prapavepruese të ligjit<sup>106</sup>;
- Parimin e interesit më të lartë të të miturit<sup>107</sup>.

Gjyqtari e ka vlerësuar aftësinë e tij për të për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes në shkallë shumë të lartë, duke shpjeguar se “*Gjatë periudhës së vlerësimit çmoj se nëçdo vendimmarrje kam shfaqur aftësi shumë të lartë për të identifikuar ligjin e zbatueshëm, interpretuar ligjin dhe arsyetuar mënyrën e zbatimit të tij mbi faktet objekt gjykimi. Gjithashtu, kam zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës në varësi të çështjes objekt gjykimi si dhe kam treguar aftësi shumë të lartë në kërkimin, identifikimin, organizimin dhe përdorimin e jurisprudencës relevante vendase dhe ndërkombëtare. Në vendimarrjet e mia, zakonisht në çdo rast i referohem dhe përdor në vendin e duhur dhe sipas llojit të qëllimit të aktit në praktikën e konsoliduar gjyqësore, praktikën e unifikuar/njësuar të Gjykatës së Lartë, praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, GJEDNJ dhe gjithë jurisprudencën, edhe në rastet kur ajo nuk përbën burim të së drejtës po i shërben intepretim të ligjit në kuadër të përafrimit të legjislacionit, veçanërisht, në rastet kur ligji është i errët, ka kundërthënie dhe është i paqartë, mungon apo nuk është i plotë.”*

## KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi të mira të interpretimit të dispozitave të ligjit material dhe procedural, duke bërë kryesisht një interpretim abstrakt të normave që gjejnë zbatim në rastin konkret, dhe në disa raste duke i integruar edhe me provat e marra. Por nuk konstatohet e njëjta aftësi e gjyqtarit në interpretimn e ligjit në raport me provat e marra në shqyrtim si në çështjet penale dhe civile, ku në disa vendime konstatohet se mungon tërësisht interpretimi i ligjit në raport me faktet e çështjes, pra si ligji gjen zbatim mbi faktet objekt gjykimi. Vetëm referimi formal i ligjit, i pashoqëruar me një analizë të dispozitave, raportit midis tyre dhe zbatimit mbi rrethanat e faktit, sipas rastit, mund të jetë tregues i një mungese të aftësive për të interpretuar ligjin. Evidentohet se gjyqtari ka identifikuar dhe zbatuar praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, GJEDNJ si dhe ka treguar kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e tij lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete. Por në një vendim konstatohet se gjyqtari referon dy vendime unifikuese të cilat nuk lidhen me çështjen dhe nuk përdoren prej tij në mbështetje të argumentimit ligjor.

---

<sup>104</sup> Vendimi nr. 1211-323, datë 15.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>105</sup> Vendimi nr. 1453-340, datë 25.10.2017; Vendimi nr. 1096-318, datë 24.09.2019; Vendimi nr. 1224-380, datë 17.10.2019; Vendimi nr. 1846-291, datë 19.09.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>106</sup> Vendimi nr. 1846-291, datë 19.09.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

<sup>107</sup> Tek vendimet me objekt “zgjidhje martese”.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” është “mbi mesatare” dhe pikëzohet me 20 pikë.*

## **1.B ARSYETIMI LIGJOR**

### *1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.*

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave i lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa i përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për tu ankuar<sup>108</sup>.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara (në thonjëza), duke u shoqëruar me dhënien e kuptimit të termit/shprehjes përkatëse, pa krijuar konfuzion për përmbajtjen apo kuptimin e tyre<sup>109</sup>. Në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit apo në kuadër të referimit të ligjeve të posaçme, përdorimi i termave teknikë është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij ose kuptohet qartë nga konteksti i arsyetimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues. Në vendimet gjyqësore për çështjet familjare (*me objekt zgjidhje martesë*), evidentohet kujdesi i gjyqtarit për zgjedhjen e gjuhës së përdorur, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre nga palët, në respektim të parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe të drejtës për jetë private dhe familjare të subjekteve të procedimit.

<sup>108</sup> Vendimi i GJEDNJ, Çështja Dadjanastassion vs Greqisë, datë 16.12.1992, faqe 33.

<sup>109</sup> Evidentohet përdorimi i termave latinë si: *extrema ratio; ratio; proprio motu; de facto; animus donandi*

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Përdor shenjat e pikësimit, thonjëzat dhe simbole të tjera, sipas përkatësisë. Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës.

Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare dhe në disa raste edhe fjali më të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme. Thuajse të gjitha vendimet janë organizuar në nënndarje, të identifikuar me tituj dhe me paragrafë të numërtuar duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, të cilët lidhen me njëri-tjetrin në mënyrë kronologjike.

Vendosja e plotë e tekstit të dispozitave ligjore të zbatueshme nuk evidentohet në të gjitha vendimet e analizuara duke mos pasur një nënndarjen me titull “Ligji i zbatueshëm”. Kjo nuk pengon në arsyetimin ligjor, zbërthimin dhe analizën e dispozitave të cituara.

Gjyqtari e ka vlerësuar aftësinë e tij për t’u shprehur qartë, në mënyrë të përmbledhur dhe të kuptueshme në shkallë shumë të lartë.

## **KONKLUZIONI**

*Në tërësi*, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.*

### **1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.**

Organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin, apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të

kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike, që juristës/ gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që duhet të zbatohet për zgjidhjen e saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzionin e arritur.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :***

Gjyqtari në hartimin e vendimit përgjithësisht ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar nga pikpamja formale, të cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale, apo të themelit të çështjes, megjithëse jo në të gjitha vendimet, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, argumentimin ligjor dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Këto të fundit vijnë gjithnjë si mbyllje e procesit të arsytimit ligjor dhe argumentimit logjik. Megjithëse konstatohet se gjyqtari ndjek përgjithësisht një metodologji strukturimi të pjesëve përbërëse të vendimit, duke e ndarë pjesën përshkruese- arsyetuese të vendimit në nëndarje, përgjithësisht të identifikuara me tituj dhe në paragrafë, duke i dhënë qartësi vendimit nga pikpamja formale, nuk konstatohet e njëjta metodologji strukturimi tek secili vendim, ku pjesë të ndryshme të pjesës arsyetuese – përshkruese, të identifikuar me tituj, pasqyrohen në vende të ndryshme të vendimit, cilat jo gjithmonë vijnë në rrjedhë logjike midis tyre. Gjithashtu, konstatohet se në disa vendime edhe pse ka një pjesë të titulluar që referon rrethanat dhe faktet, përmbajtja e kësaj pjesë nuk e reflekton atë, pasi në to mungon pasqyrimi i rrethanave të faktit siç ka rezultuar nga gjykimi.

Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese- arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

*Në pjesën hyrëse* përgjithësisht gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit e çështjes, trupi gjykues dhe sekretaria gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i shqyrtimit (*padisë ose kërkesës në çështjet civile dhe akuza ose objekti i kërkesës në çështjet penale*), baza ligjore si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur. Në dy rast në këtë pjesë është marrë në analizë edhe fakti se çështja është në juridiksionin gjyqësor dhe në kompetencën lëndore e tokësore të gjykatës.

*Pjesa përshkruese-arsyetuese* është e ndarë në disa nënpjesë, të cilat përgjithësisht janë të identifikuara me tituj, duke orientuar lexuesin për përmbajtjen e secilës pjesë të vendimit. Por konstatohet se mënyra e organizimit të pjesës përshkruese -arsyetuese të vendimeve burim vlerësimit nuk ndjek gjithmonë të njëjtën rënditje. Gjithashtu, në disa raste konstatohet se

përmbajtja e nënpjesës së vendimit jo gjithmonë ka lidhje me titullin e vendosur në këtë pjesë. Megjithatë konstatohet se pjesa arsyetuese ndahet në këto pjesë:

(i) *procedura*, duke u ndalur kryesisht në ecurinë procedurale të çështjes si dhe në aspekte që lidhen me të drejtat e palëve, njoftimin dhe pjesëmarrjen e tyre në gjykim, analizën dhe vlerësimin kryesisht të gjykatës lidhur me çështje të juridiksionit, kompetencës, etj. Në këtë pjesë, në vendimet penale të themelit, ndryshe nga ato të seancës paraprake, evidentohen edhe vendimmarrjet e ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. në rastin e shqyrtimit të kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar në çështjet penale të themelit. Në shumicën dërrmuese të vendimeve (përveç 3 vendimeve seancë paraprake dhe 1 vendim miratim marrëveshje fajësie), rezulton se nënpjesa “procedura” mungon dhe si rezultat, elementët procedurale lidhur me kompetencën, juridiksionin, përbërjen e gjykatës, seancën e pajtimit të analizohen, sikurse është cituar edhe më sipër, direkt sapo fillon pjesa përshkuese arsyetuese pas “Vëren”. Nën pjesa “Procedura” mungon edhe në disa vendime penale apo civile<sup>110</sup>, por elementët proceduralë janë shqyrtuar direkt sapo fillon pjesa përshkuese arsyetuese pas “Vëren”. Ndërsa tek 3 vendimet, seancë paraprake dhe një vendim, që i përket gjyqimit me marrëveshje, nën pjesa “Procedura” është vendosur në pjesën e dytë të pjesës arsyetuese përshkuese, pas pasqyrimin të rrethanave të çështjes.

(ii) *Rrethanat e faktit*. Rezulton që prezantimi i faktit në disa raste është i qartë dhe konciz, ku herë pas herë referohen dhe provat e administruara dhe të marra në shqyrtim, kryesisht në çështjet penale. Ndërsa më disa raste, sidomos tek çështjet civile, gjyqtari nuk bën një përshkrim dhe analizë të rrethanave të faktit siç kanë rezultuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Kështu në disa vendime, megjithëse ka një pjesë të titulluar “Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se”, “Rrethanat e çështjes” apo “rrethanat e çështjes / pretendimet e palëve”, në të janë pasqyruar vetëm rrethanat e faktit siç janë pretenduar nga palët në gjykim, duke pasqyruar në mënyrë të detajuar pretendimet e tyre mbi kërkimet e paraqitura në raport me faktet e çështjes dhe se si gjen zbatim ligji në rastin konkret. Në disa vendime civile mungon nën pjesa e titulluar “rrethanat e çështjes” dhe rrethanat përshkruhen dhe analizohen në fillim të pjesës arsyetuese- përshkuese të vendimit. Pra, në shumicën e vendimeve, gjyqtari pas “Vëren”, paraqet si rrethanat procedurale ashtu edhe ato faktike, fakte të cilat paraqiten në mënyrë tepër të përmbledhur, duke mos referuar provat mbi bazën e të cilës rezultojnë këto fakte apo nga të cilat ekstrahohet faktet konkrete.

(iii) *Vlerësimi i gjykatës lidhur me çështjen*. Pas evidentimit dhe analizës së elementëve procedurale, fakteve të çështjes dhe referimit të ligjit të zbatueshëm, arsyetimi vijon me një nënndarje të titulluar kryesisht “Vlerësimi i gjykatës”, në të cilin, sipas kategorisë së vendimeve gjyqtari zhvillon analizën ligjore të çështjes. Kjo analizë, referuar kompleksitetit të çështjes është e organizuar në disa rasteve në nënndarje, ku merren në analizë secili nga kërkimet e objektit të padisë, apo

---

<sup>110</sup> Vendimi nr. 27, datë 27.03.2018; Vendimi nr. 122-50, datë 05.02.2018; Vendimi nr. 173, datë 07.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin etj.

analizën lidhur me përgjegjësinë penale për secilin të pandehur apo vepër për të cilën procedohet, në vendimet penale. Në këtë pjesë konstatohet se mendimi juridik është i ndarë në paragrafë të numërtuar, që të mundësojë përgjithësisht një kuptim të qartë të analizës juridike. Në *vendimet penale të themelit* gjyqtari e ka organizuar këtë pjesë të vendimit duke analizuar fillimisht elementët e figurës së veprës penale për secilin të pandehur për të vijuar me pas me analizën ligjore në drejtim të caktimit dhe individualizimit të dënimit. Në *vendimet civile themeli dhe familjare* burim vlerësimi, në një pjesë të tyre, gjyqtari e organizon pjesën e analizës ligjore duke marrë në vlerësim, në mënyrë të veçantë secilin kërkim objekt padie, apo secilin elementët që ai vlerëson të nevojshme për t'iu nënshtruar analizës ligjore si p.sh lidhur me kërkesën për zgjidhjen e martesës, pasoja e zgjidhjes së martesës ndërmjet bashkëshortëve, pasojat e zgjidhjes së martesës tek fëmijët (lënia për rritje dhe edukim, detyrimi ushqimor); lidhur me përmbushjen e detyrimit kontraktor<sup>111</sup>; lidhur me kushtet që duhen plotësuar për revokimin e kontratës së dhurimit<sup>112</sup> apo për kthimin e pronës<sup>113</sup> etj. Pjesë e analizës ligjore, në përmbajtje apo në përfundim të argumentimit të tij lidhur me zgjidhjen e çështjes, janë edhe pretendimet e palëve të cilat merren në analizë lidhur edhe me faktet e provuara apo edhe më vete. Në tërësi, gjyqtari organizon pjesën e arsytimit ligjor të vendimit duke shtjelluar dhe renditur fillimisht argumentet në mbështetje të konkluzionit dhe më pas jep konkluzionin e tij mbi bazueshmërinë ose jo të kërkimeve objekt padie. Në disa çështje penale themeli gjëndet edhe një nënpjesë e fundit e quajtur “në lidhje me zbatimin e së drejtës në këtë çështje” e cila lidhet kryesisht me individualizimin e vendimit. Ndërkohë në çështjet penale, analiza ligjore organizohet duke filluar me referimin e ligjit material të zbatueshëm, zberthimin dhe analizën e elementëve të figurës së veprës penale konkrete dhe përqasjen e tyre me faktin penal të provuar në gjykim, për të vijuar me konkluzionin mbi ekzistencën e veprës penale dhe fajësinë e të pandehurit dhe më tej, me analizën në një pjesë më vetë, lidhur me përcaktimin e llojit dhe të masës së dënimit. Në përfundim të analizës ligjore në tërësi, ose në lidhje me secilën çështje të shtruar për vlerësim apo kërkesë të objektit të padisë, gjyqtari konkludon lidhur me çështjen, duke e paraqitur këtë pjesë, si sintezë të analizës ligjore të kryer.

*Në pjesën e dispozitivit* gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarit dhe sekretares gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim: disponimi i gjykatës mbi : (i) çdo kërkim të objektit të padisë apo kërkesës (*pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë*), (ii) përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet (*deklarimin fajtor apo të pafajshëm*), apo mënyrën e disponimit në çështjet specifike të seancës paraprake (*dërgimin në gjyq apo pushimin e procedimit penal*), (iii) dënimin dhe masën e dënimit, (iv) llogaritjen e dënimit, (v) mënyrën e ekzekutimit të tij, (vi) disponimi mbi provat materiale dhe (vii) shpenzimet gjyqësore.

<sup>111</sup> Vendimi nr. 1453-340, datë 25.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>112</sup> Vendimi nr. 1224-380, datë 17.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>113</sup> Vendimi nr. 1846-291, datë 19.09.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.



Disponimi lidhur me shpenzimet gjyqësore përgjithësisht është i qartë dhe i plotë, pasi në pjesën më të madhe të vendimeve bëhet pasqyrimi i shpenzimeve gjyqësore, dhe përcaktimi i saktë i raportit të pjesës së shpenzimeve që i ngarkohen palëve në rastin e pranimit të pjesëshëm të padisë (në çështjet civile). Identifikimi dhe përcaktimi i saktë i shpenzimeve gjyqësore është pjesë tepër e rëndësishme e vendimit, pasi lidhet me fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit, gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj. Në vendimin civil nr.1224-380, datë 17.10.2019, rezulton se gjyqtari nuk ka disponuar lidhur me ekzekutimin e vendimit në përputhje me nenin 310 të K.Pr.Civile, të ndryshuar me ligjin nr.38/2017, ku parashikohet se:” Në pjesën urdhëruese, ndër të tjera, duhet të përmenden; 1/1. Nëse gjykata vendos detyrime për palët, përmbajtjen konkrete të tyre dhe se vendimi është i ekzekutueshëm nga përmbartuesi gjyqësor”, sipas të cilës gjykata duhet të përcaktojë se vendimi është i ekzekutueshëm nga shërbimi përmbartimor dhe se vendimi përbën titull ekzekutiv, sipas parashikimit të nenit 511 të K.Pr.Civile<sup>114</sup>. Ndërsa në disa vendime civile dhe familjare<sup>115</sup> rezulton se gjyqtari ka disponuar me lëshimin e urdhërit të ekzekutimit më vete, kur dispozitat e KPRC, të ndryshuara kanë parashikuar se gjyqtari duhet të shprehet se vendimi përbën titull ekzekutiv, siç citohet shprehimisht në nenin 310 të KPRC.

Përgjithësisht vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural penal ose civil, referuar natyrës së tyre ose kategorisë së çështjes, dhe konkretisht elementët e përcaktuar në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile dhe familjare, (ii) nenet 332/ç, 332/dh dhe 332/e dhe nenin 329/b të K.Pr.Penale, në vendimet e seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e procedimit penal, (iii) nenin 383 të K.Pr.Penale, në vendimet penale themelit, etj.

Siç u theksua më lartë, gjyqtari megjithëse nga pikpamja formale duket se ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, nga përmbajtja e tyre nuk konstatohet një gjë e tillë. Secili vendim, ka një strukturë të caktuar, që ndryshon nga tipet e ndryshme të vendimeve, dhe ndonjëherë fjalit hyrëse përshkruese të vendosura si titull nuk pasqyrojnë përmbajtjen konkrete të pjesës së vendimit.

Megjithatë titujt e ndarjeve të vendimit gjyqësor (*procedura, rrethanat e çështjes, ligji i zbatueshëm, vlerësimi/arsyetimi i gjykatës*) nuk janë të vetme mjete të majftueshme për organizimin e argumentit logjik. Janë paragrafët, të cilët gjyqtari i përdor rregullisht, ata që e organizojnë shkrimin sipas ideve dhe lehtësojnë të kuptuarit e mendimit, duke e ndarë në

---

<sup>114</sup> Neni 511 I KPrC, parashikon se;” Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, i cili:

a) për rastet e parashikuara nga shkronja “a” dhe “b”, të nenit 510, të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin në dispozitivin e vendimit”

<sup>115</sup> vendimi nr.2662-550, Datë 26.12.2018, vendimin 71-16, datë 22.02.2019, vendimin nrr.1264-196, datë 07.06.2018, vendimin nr.361-111, datë 28.03.2019, vendimin nr.578-178, datë 10.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

njësi më të thjeshta. Por nga përmbajtja e paragrafëve në disa vendimi<sup>116</sup>, konstatohet se jo gjithmonë ato janë rënditur në atë mënyrë që mendimi të vijë rrjedhshëm, njëri pas tjetrit.

Gjyqtari e ka vlerësuar aftësinë e ka vlerësuar aftësinë e tij për të hartuar vendimin sipas një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar në shkallë shumë të lartë, por nuk ka dhënë shpjegime.

## KONKLUZIONI

*Në tërësi*, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi “mbi mesatare” në ndjekjen e një strukture të organizuar të vendimit, përgjithësisht e ndarë në tituj dhe gjithmonë mendimi është ndarë në paragrafë. Gjyqtari ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit apo të vlerësuar kryesisht nga gjykata; parashtrimi i rrethanave të faktit, ligjin e zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga gjykata, ndërsa në disa vendime strukturimi nuk bëhet sipas këtij rendi logjik. Në disa raste konstatohet që nëndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës dhe fjali tematike, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit si dhe në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së tij duke mundësuar përgjithësisht lexim të organizuar dhe të strukturuar në rrjedhë logjike. Por konstatohet se jo gjithmonë fjalitë tematike të përdorua pasqyrojnë përmbajtjen e saktë të pjesës së vendimit. Kështu në disa vendime, megjithëse ka një nënpjesë që identifikon rrethanat dhe faktet e çështjes, në atë pjesë mungon pasqyrimi i rrethanave dhe fakteve siç kanë rezultuar nga gjykimi, duke pasyquar këto rrethana siç pretendohet nga secila palë ndërgjyqëse. Gjithashtu, edhe pjesa e fundit e vendimit (dispozitivi) jo gjithmonë është i qartë në lidhje me disponimin mbi faktin nëse vendimi përbën titull ekzekutiv dhe kur lëshohet urdhëri i ekzekutimit.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, është “mbi mesatare” dhe pikëzohet me 8 pikë.*

### **1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.**

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballlet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur

---

<sup>116</sup> Shih vendimin nr.1846-291, datë 19.09.2018 si dhe vendimin nr.1224-380, datë 17.10.2019 të Gjykatës së Rrehit Gjyqësor Kurbin.

në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave i lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa i përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për tu ankuar<sup>117</sup>.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :***

Në vendimet e analizuara, përgjithësisht rezulton një nivel i mirë arsyetimi, duke shqyrtuar dhe argumentuar elementët e nevojshëm të vlerësuar nga gjyqtari në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale të gjykimit, kryesisht çështje të kompetencës lëndore; përcaktimit të barrës së provës dhe rolin e gjykatës në funksion të vlerësimit të shkakut ligjor të padisë; rolin dhe funksionin e gjyqtarit të seancës paraprake dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes në këtë fazë të procedimit; procedimit me gjykim të shkurtuar si dhe pjesëmarrjen dhe të drejtat e të dëmtuarit në gjykim, etj.

Arsyetimi i vendimeve përfundimtare, pas përcaktimit të fakteve të çështjes, të cilat siç është theksuar në Raport jo gjithmonë paraqiten në mënyrë të saktë, të plotë dhe koncize, zhvillohet mbi bazën e një analize juridike të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material (civil apo penal), duke bërë një analizë tërësore dhe të përmbledhur të provave të administruara, në funksion të përcaktimit të fakteve të vlerësuar si të provuara në gjykim. Në disa vendime burim vlerësimi, evidentohet kujdesi i gjyqtarit për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore përpara aplikimit mbi faktet konkrete, e cila zë pjesën më të madhe të vendimit, në raport me analizën e këtyre koncepteve në raport me faktet e çështjes.

***Në disa nga vendimet civile burim vlerësimi*** gjyqtari i kushton rëndësi analizës me të zgjeruar të instituteve dhe koncepteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme, duke qenë më e kufizuar në analizën e këtyre instituteve dhe koncepteve në raport me rrethanat konkrete të çështjes, apo se si zbatohen ato në një situatë të caktuar. Konkretisht konstatohet se gjyqtari analizon;

- (i) institutit të zgjidhjes së martesës dhe përcaktimit të përgjegjësisë prindërore, duke analizuar martesën, shkaqet e zgjidhjes së saj, pasojat e zgjidhjes së martesës për bashkëshortët dhe fëmijët e mitur, duke u ndalur në këtë drejtim në pasojat në lidhje më mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe ato me karakter material, analizë e cila mbështetet në çdo rast në parimin e interesit më të lartë të fëmijës<sup>118</sup>;
- (ii) kthim shume që rrjedh nga mospërmbushja e kontratës, marrëdhënia juridike e detyrimit rrjedhur nga kontrata lidhur mes të paditurit dhe Raiffeisen Bank sh.a.,

---

<sup>117</sup> Vendimi I GJEDNJ, Çështja Dadjanastassion vs Greqisë, datë 16.12.1992, faqe 33.

<sup>118</sup> Vendimi nr. 1264-196, datë 07.06.2018; Vendimi nr. 649-174, datë 20.04.2017; Vendimi nr. 1463-459, datë 16.12.2019; Vendimi nr. 361-111, datë 28.03.2019

- fuqia juridike e saj, si dhe mospërmbushja e detyrimeve përkatëse të palës së paditur për kthimin e shumës në bazë të saj<sup>119</sup> ;
- (iii) padia e revokimit të kontratës së dhurimit, e drejta për të kërkuar revokimin e kontratës së dhurimit, duke evidentuar rastet dhe rrethanat e përligjura prej Kodit Civil dhe verifikimi i kësaj të drejte në padinë e paditësit dhe ndërhyrësit kryesor<sup>120</sup>;
- (iv) padia për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe fatura e shitjes së energjisë elektrike si titull ekzekutiv, për të verifikuar në rrethanat e çështjes objekt gjykimi nëse fatura e kundërshtuar përfaqëson apo jo një titull të vlefshëm ekzekutiv, verifikimi i së drejtës së ngritjes së padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv në terma të parashkrimit, si dhe në pikëpamje të themelit, në lidhje me ekzistencën e detyrimit në themel të titullit ekzekutiv<sup>121</sup> ;
- (v) padia e rivendikimit, natyra e vendimeve të ish-KKKP, elementët që duhet të mbahen në konsideratë referuar ligjit nr. 9235/2004 i ndryshuar për njohjen e së drejtës së pronësisë ish-pronarit, si dhe verifikimi i zbatimit të tyre në rrethanat konkrete të çështjes<sup>122</sup> ;
- (vi) regjimit juridik të “Vërtetimit gjyqësor të fakteve juridike”, ku sqarohet se në mënyrë që gjykata të shqyrtojë kërkesën për vërtetimin e faktit juridik, duhet të ekzistojnë dy kushte: së pari, interesi për të cilin kërkuesi kërkon njohjen e viteve të punës pranë personit të tretë; së dyti, akti me të cilin vërtetohet një e drejtë personale, nuk ekziston për shkak se ka humbur, është zhdukur ose nuk mund të ribëhet përsëri dhe nuk ka ndonjë rrugë tjetër për marrjen e tij<sup>123</sup>.

***Në vendimet penale burim vlerësimi***, gjyqtari paraqet dhe analizon faktet të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim, sipas përshkrimit të bërë nga organi i prokurorisë, e cila në zë pjesën më të madhe arsyetimit të vendimit, dhe merr në analizë elementët e figurës së veprës penale për të cilën procedohet, rolin dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit në raport me faktin penal, analizë e cila paraqitet tepër e përmbledhur dhe skematike. Çdo fakt i vlerësuar si i provuar shpeh herë lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me provën/provat përkatëse, me aspektet ligjore konkrete të cilat ato mbështesin, si dhe elementin që sjell secila prej tyre në shërbim të provueshmërisë së tij. Gjyqtari integron faktin e provuar me analizën dhe interpretimin e ligjit të zbatueshëm në rastin konkret, si në drejtim të kualifikimit ligjor të faktit penal, ashtu edhe në drejtim të vlerësimit të kushteve ligjore për zgjidhjen e çështjeve me karakter procedural. Por konstatohet se argumenti logjik përgjithësisht dominohet nga analiza abstrakte e koncepteve ligjore të së drejtës materiale ose procedurale, në raport me zbërthimin dhe analizën e këtyre koncepteve ligjore në lidhje me faktet e çështjes dhe aktet provuese mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtarit, të cilat përgjithësisht vetëm përshkruhen siç kanë rezultuar pa u bërë një analizë individuale nga gjyqtari.

---

<sup>119</sup> Vendimi nr. 71-16, datë 22.01.2019; Vendimi nr. 2662-550, datë 26.12.2018

<sup>120</sup> Vendimi nr. 1224-380, datë 17.10.2019

<sup>121</sup> Vendimi nr. 1657-372, datë 13.11.2017;

<sup>122</sup> Vendimi nr. 1846-291, datë 19.09.2018

<sup>123</sup> Vendimi nr. 008-001, datë 08.01.2018

Gjyqtari përgjithësiht ndalet në evidentimin e qartë dhe në mënyrë të natyrshme të lidhjes shkak-pasojë mes veprimeve të të pandehurit në raport me faktin penal të provuar në çështjet e themelit, faktin penal objekt akuze në çështje të seancës paraprake. Në çdo rast interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, edhe pse kjo pjesë paraqitet tepër e përmbledhur në disa raste, i shërben arsyetimit ligjor dhe zhvillimit të argumentimin logjik, në mbështetje të konkluzioneve të tij për zgjidhjen e çështjes, kryesisht në drejtim të :

- (i) analizës së figurës konkrete të veprës penale për të cilën procedohet, zberthimin dhe analizën e elementëve e saj si dhe autorësisë e të pandehurit<sup>124</sup>;
- (ii) institutin procedural të gjykimit të shkurtuar, duke analizuar në çdo rast kushtet procedurale për pranimin e tij së bashku me analizën dhe vlerësimin mbi kushtet thelbësore që vlerësohen për procedimin me këtë rit të posaçëm gjykimi<sup>125</sup>;
- (iii) analizës lidhur me kushtet dhe kriteret ligjore të përcaktimi dhe individualizimit të dënimit, analizës lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese që ndikojnë për përcaktimin e dënimit si dhe aplikimin në këtë drejtim të parimeve mbi të cilat caktohet dënimi penal në funksion të arritjes së qëllimit të tij. Po ashtu gjyqtari zhvillon analizën e kushteve ligjore të aplikimit të alternativave të dënimit me burgim duke u ndalur në analizën e qëllimit të aplikimit të tyre në raport me arritjen e qëllimit të dënimit penal apo zbatimin e parimit të caktimit të dënimit në mënyrë të drejtë dhe proporcionale<sup>126</sup>;
- (iv) analizën e figurës së gjyqtarit të seancës paraprake, rolin e tij, qëllimin e kësaj fazë të procedimit dhe elementet që janë objekt kontrolli nga gjykata me qëllim përgatitjen e çështjes për gjykim. Në kuadër të kësaj analizë gjyqtari ndalet dhe analizon dispozitat mbi pavlefshmërinë e akteve dhe papërdorshmërinë e provave, mjaftueshmërinë e provave dhe ligjshmërinë e marrjes së tyre, para aplikimit të tyre mbi faktin konkret dhe vlerësimin përfundimtar mbi çështjen<sup>127</sup>

Konstatohet se gjyqtari i kushton rëndësi identifikimit dhe analizës së koncepteve ligjore të së drejtës materiale ose procedurale në lidhje me konkluzionet e arritura për zgjidhjen e çështjes, e cila zë dhe pjesën më të madhe të vendimit, duke bërë një analizë për qëllimin dhe funksionin përkatës të dispozitave, si dhe të zberthimit të kushteve apo elementëve të nevojshëm me qëllim që dispozita përkatëse të gjejnë zbatim në rastet konkrete në shërbim të konkluzioneve të arritura për zgjidhjen e çështjes. Por nuk konstatohet e njëjta shkallë kujdesi tek të gjitha vendimet, si tek vendimet civile, familjare apo dhe kërkesat penale, në drejtim të zhvillimit të analizës ligjore dhe argumentit logjik, në raport me faktet e provuara në funksion të mbështetjes së marrëdhënies shkak- pasojë, e cila në disa raste paraqitet tepër skematike

---

<sup>124</sup> Në të gjitha vendimet penale të themelit apo edhe ato të seancës paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq gjyqtari ndalet në analizën e elementëve të figurës së veprës penale dhe përjasjen e faktit të provuar në raport me to, në funksion të vlerësimit të saj mbi cilësimin juridik të faktit penal për të cilin procedohet.

<sup>125</sup> Në shumicën e vendimet penale themeli.

<sup>126</sup> Në vendimet penale themeli në të cilat është disponuar me dënimin e të pandehurit.

<sup>127</sup> Në vendimet penale të kategorisë “seancë paraprake”

dhe në disa raste argumenti mungon, duke konkluduar direkt në konkluzionet e gjyqtarit lidhur me provueshmërinë dhe bazueshmërinë në ligj e në prova të kërkimeve të paraqitura. Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, analiza përqendrohet kryesisht në interpretimin abstrakt të dispozitave, e cila dominon pjesën e vlerësimit të gjykatës, duke e shoqëruar edhe me praktikën e unifikuar të Gjykatës së Lartë (praktikë e cila në një vendim nuk lidhet me mbështet argumentin juridik të gjyqtarit), apo dhe të qëndrimeve të mbajtura nga Gjykata Kushtetuese, ndërsa analiza ligjore në raport me faktet e provuara, pra argumenti logjik në raport me faktet e provuara paraqitet në mënyrë të përmbledhur, duke mos integruar gjithmonë si pjesë të saj edhe provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtarit për provueshmërinë e fakteve konkrete. Analiza e e koncepteve ligjore të së drejtës materiale ose procedurale në lidhje me konkluzionet e arritura për zgjidhjen e çështjes, është shumë e rëndësishme, por nuk është e mjaftueshme në raste se kjo analizë nuk shoqërohet edhe më një analizën të detajuar të provave të marrë në shqyrtim, e cila gjithashtu është një pjesë shumë e rëndësishme e arsytimit të vendimit gjyqësor në tërësi. Gjyqtari nuk duhet të jetë thjesht përshkrues i rrethanave apo i provave siç ka rezultuar nga shqyrtimi gjyqësor e aq më pak me përshkrimin e tyre sipas pretendimeve të palëve, por duhet të analizojë provat në raport me njëra tjetrën, duke e gërshetuar arsytimin e tij në raport ligjin që gjen zbatim. Përgjithësisht konstatohet rrjedha logjike në arsytimin e vendimit dhe cilësia analitike e vendimit është në një nivel mesatare, pasi nuk spikat analiza juridike e koncepteve dhe e dispozitave ligjore në raport me rrethanat konkrete të çështjes, e cila lidhet drejtpërdrejte me konkluzionet e arritura. Kjo mënyrë e të shkruarit të vendimeve jo gjithmonë evidenton qartë faktet e çështjes, apo nëse faktet konkrete të çështjes janë të asaj natyre, kualiteti apo cilësia juridike siç kërkohen nga dispozita konkrete që gjen zbatim, dukë bërë më pas lidhjen e drejtpërdrejtë me konkluzionet e arritura.

***Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve.***

Arsytimi i vendimeve përgjithësisht është i qartë dhe gjithëpërfshirës, duke marrë në analizë dhe duke i dhënë përgjigje pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse, të cilat janë integruar ndonjëherë në pjesën “rrethanat e faktit” ashtu edhe në pjesën e “vlerësimit të gjykatës”, analizë e cila paraqiten në mënyrë të përmbledhur. Por jo gjithmonë gjyqtari identifikon qartë dhe në mënyrë të plotë pretendimet e palëve, duke i paraqitur ato të ndara, por ata dalin si rezultat i analizës juridike. Në çështjet më komplekse, gjyqtari është kujdesur të pasqyrojë dhe marrë në analizë pretendimet e palëve ndërgjyqëse (duke krijuar edhe paragrafë me fjali hyrëse në lidhje me këto pretendime), si në raport me arsytimin e koncepteve ligjore dhe zbërthimin e këtyre koncepteve në raport me rrethanat e provuara dhe provat përkatëse ku palët bazojnë pretendimet e tyre. Por edhe në këtë drejtim nuk konstatohet i njëjti kujdes i gjyqtarit, sidomos në analizën e pretendimeve të palëve në raport me ligjin, duke i integruar me faktet e çështjes. Kështu në vendimin nr.1224-380, datë 17.10.2019, mungon analiza e të gjitha kërkimeve të palës paditëse të pasqyruar në objektin e kërkesë padisë, të cilat janë pranuar në tërësi nga gjykata. Ndërsa në vendimin nr.1846-291, datë 19.09.2018, gjyqtari nuk i ka dhënë një përgjigje të argumentuar për kërkimin e parashtruar në padi, lidhur me faktin nëse sendi ka qenë i lirë në kuptim të ligjit dhe a mundet

ai t'i kthehet ose kompesohet fizikisht pronarit sipas ligjit "Për kthimin dhe kompesimin e pronave".

Gjyqtari e ka vlerësuar aftësinë e tij në drejtim të cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik në shkallë shumë të lartë, duke shpjeguar se "Vlerësoj se përmbajtja e vendimeve është gjithëpërfshirëse, duke i dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve. Në çdo vendim pasqyroj pretendimet e palëve qofshin pretendime që lidhen me anën procedurale ashtu edhe ato që i referohen themelit të çështjes. Pas pasqyrimin të tyre (shpesh në të njëjtën mënyrë siç është parashtruar prej tyre e në disa raste në mënyrë të përmbledhur), në pjesën e titulluar "Vlerësimi i Gjykatës" analizoj çdo pretendim të palëve, duke iu dhënë përgjigje dhe arritur në konkluzion përkatës për secilën prej pretendimeve të tyre. Gjithashtu, vlerësoj se kam treguar aftësi për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në një situatë të caktuar. Në arsyetimin e realizuar zbatoj rregullat e logjikës formale të induksionit e deduksionit, përdor kundëranalizën, ballafaqoj faktet me njëra-tjetrën dhe me ligjin dhe në përfundimet e arritura për të qenë të kuptueshme, konkrete, detyruese dhe të ekzekutueshme nga ana e zyrave të përmbartimit gjyqësor shtetëror ose privat."

## KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësuar në tërësinë e tyre dhe në raport me natyrën çështjes, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në treguesin "Cilësia e analizës dhe argumentit logjik". Në disa vendime burim vlerësimi, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe mbështetet në disa raste në qëndrimet e praktikës gjyqësore, megjithëse nuk spikat interpretimi individual i ligjit dhe as argumentimi logjik. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim kryesisht në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin "cilësia e analizës dhe argumentit logjik" vlerësohet "shumë e lartë" dhe duhet të pikëzohet me 25 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha llojet e çështjeve të përzgjedhura, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërës prej tyre.

KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
88	Shumë mirë

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.*

### 2.A AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË.

#### 2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej 736 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak” dhe “Penale seancë parapake”.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 552 çështje për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, 140 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati ndërsa 412 çështje janë shqyrtuar brenda afateve ligjore. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (140 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (552 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar **25.3 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.**

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar treguesin “Respektimi i afateve ligjore” në shkallë shumë të lartë ku ndër të tjera shpjegon: “Nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit, pra nga data 01.01.2017-31.12.2019 kam gjykuar 2013 çështje. Totali i dosjeve të përfunduara në vitin 2017 janë 564 dhe përfunduara jashtë afatit ligjor janë vetëm 86, në vitin 2018 janë 756 dhe përfunduara jashtë afatit janë vetëm 82 dhe në vitin 2019 janë 693 dhe përfunduara jashtë afatit janë vetëm 175. Vazhdimisht jam përpjekur që të respektoj afatet ligjore brenda të cilës duhet të përfundojë gjykimi i një çështje, por njëkohësisht duke i dhënë përparësi edhe garantimit të të drejtave të



*palëve ndërgjyqëse si dhe kryerjes së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, me qëllimin e vetëm zgjidhjen e drejtë të çështjes. Gjithashtu, dëshiroj të vë në dukje se seancat gjyqësore nuk janë shtyrë për shkaqe që lidhen me mua si gjyqtar i çështjes, duke qenë gjithmonë i pranishëm në punë dhe duke mos munguar pothuajse asnjë ditë. Tjetër fakt që dua të theksoj është se në shumë raste afati ka kaluar vetëm disa ditë.”*

Në përlogaritjen e afateve ligjore, për të gjitha dosjet, përlogaritja e afateve do të fillojë nga data e shortimit (pra, data kur çështja ka shkuar pranë gjyqtarit), dhe jo ajo e regjistrimit. Në të gjitha dosjet, në përlogaritje do të zbriten:

- leja vjetore e muajit gusht prej 35 ditësh (ligji parashikon 25 ditë pune për gjyqtarët apo 35 ditë kalendarike) ;
- festat e fundvitit dhe afati i mbartjes së dosjeve, 6 ditë ;

Kështu, referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton si vijon:

- për vitin 2017
  - (i) në tabelën nr. 2, 13 çështjet me objekt “*Lëshim urdhër ekzekutimi*”<sup>128</sup>, me nr. rendor 9-12, janë shortuar më datë 18.01.2017 dhe kanë përfunduar në 25.01.2017, pra brenda 7 ditësh ; me nr. rendor 57, është shortuar më datë 27.03.2017 dhe kanë përfunduar në 03.04.2017, pra brenda 6 ditësh; me nr. rendor 58, është shortuar më datë 31.03.2017 dhe kanë përfunduar në 06.04.2017, pra brenda 6 ditësh ; me nr. rendor 66, është shortuar më datë 11.05.2017 dhe kanë përfunduar në 17.05.2017, pra brenda 6 ditësh ; me nr. rendor 86, është shortuar më datë 29.05.2017 dhe kanë përfunduar në 05.06.2017 , pra brenda 6 ditësh ; çështjet me nr. rendor 88-89, janë shortuar më datë 31.05.2017 dhe kanë përfunduar në 06.06.2017, pra brenda 6 ditësh; me nr. rendor 90, është shortuar më datë 21.06.2017 dhe kanë përfunduar në 28.06.2017, pra brenda 7 ditësh; çështja me nr. rendor 98, është shortuar më datë 18.07.2017 dhe ka përfunduar në 24.07.2017, pra brenda 6 ditësh; me nr. rendor 151, është shortuar më datë 02.11.2017 dhe ka përfunduar në 09.11.2017, pra brenda 7 ditësh; Tejkalmi prej 1-2 ditë për disa nga çështjet do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë do **të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor 5 ditor.**
- për vitin 2018
  - (i) në tabelën nr. 3, çështja me nr. rendor 33, me objekt « *Lëshim urdhër i menjëhershëm mbrojtje dhe vërtetimi*”, është shortuar me 21.05.2018 dhe ka përfunduar në 14.06.2018, për 24 ditë. Neni 20 i ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, parashikon afatin 20 ditor të shqyrtimit, duke filluar nga dita e lëshimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Urdhëri i menjëhershëm i mbrojtjes sipas nenit 18 pika 1 të Ligjit nr.9669/2006 të ndryshuar, lëshohet brenda 48 orëve nga regjistrimi i çështjes<sup>129</sup>. Në këto kushte, duke llogaritur

<sup>128</sup> Neni 510 të K. Pr. Civile në fuqi në kohën e regjistrimit të çështjes parashikonte afat ligjor 5 ditor të shqyrtimit të kërkesës për lëshim urdhëri ekzekutimi. Ndërsa Ligji nr.38/2017, i cili ka hyrë në fuqi me dt.05.11.2017 (gjashtë muaj pas botimit në fletoren zyrtare, i cili rezulton se është botuar në Fletoren Zyrtare nr.98, viti 2017, datë 05.05.2017), nuk ka parashikuar afat ligjor për shqyrtimin e këtyre kërkesave.

<sup>129</sup> Neni 18 pika 1, në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes parashikon se :” *Gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme:b) të subjekteve të tjera të dhunës në marrëdhëniet familjare, brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës”..*

afatin maksimal të shqyrtimit të kërkesës për lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes si dhe afatin maksimal të shqyrtimit të kësaj kërkesë në fazën e vërtetimit prej 20 ditëve, nga dita e dhënies së vendimit për lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes, rezulton se afati ligjor duhet të llogaritet 22 ditë. Kështu rezulton se në rastin konkret afati është tejkaluar me 2 ditë. Tejkalmimi me 2 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë çështja do **të konsiderohet si e përfunduar brenda afatit 22 ditor të parashikuar nga ligji.**

(i) në tabelën nr. 10, çështjet me objekt *“Ankim kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal”*<sup>130</sup>, me nr. rendor 67, është shortuar me 17.05.2018 dhe ka përfunduar në 18.06.2018, për 31 ditë. Tejkalmimi me 1 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë çështja do **të konsiderohet si e përfunduar brenda afatit 30 ditor të parashikuar nga ligji.**

(ii) në tabelën nr. 11, çështjet me objekt *“Dërgim çështje në gjyq”*<sup>131</sup>, me nr. rendor 39 është shortuar më datë 23.07.2018 dhe ka përfunduar me datë 18.09.2018, për 1 muaj e 25 ditë. Nëse zbresim këtu lejen vjetore të muajit gusht rezulton se çështja është gjykuar për 20 ditë, pra brenda afatit ligjor. Çështja me nr. rendor 45 është shortuar më datë 24.09.2018 dhe ka përfunduar me datë 25.10.2018, për 31 ditë. Tejkalmimi me 1 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë çështjet do **të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor 30 ditor.**

- për vitin 2019

(i) në tabelën nr. 1, çështja me nr. rendor 18, me objekt *“Kundërshtim veprimesh përmbaremore”*<sup>132</sup>, është shortuar më datë 25.02.2019 dhe ka përfunduar me datë 19.03.2019, për 22 ditë. Tejkalmimi me 2 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë çështja do **të konsiderohet si e përfunduar brenda afatit ligjor 20 ditor.**

(ii) në tabelën nr. 10, çështja me nr. rendor 80, me objekt *“Zëvendësim i masës së sigurimit”*<sup>133</sup>, është shortuar me 16.04.2019 dhe ka përfunduar në 23.04.2019, për 7 ditë. Tejkalmimi me 2 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë çështja do **të konsiderohet si e përfunduar brenda afatit 5 ditor të parashikuar nga ligji.**

(iii) në tabelën nr. 11, çështjet me nr. rendor 19, 49, 77 dhe 83 me objekt *“Dërgim çështje në gjyq”*, janë shortuar më datë 24.01.2019 dhe ka përfunduar me datë 26.02.2019, për 32 ditë, shortuar më datë 15.04.2019 dhe ka përfunduar me datë 15.05.2019, për 30 ditë ; shortuar më datë 30.07.2019 dhe ka përfunduar me datë 11.09.2019, për 1 muaj e 11 ditë ; shortuar më datë 25.07.2019 dhe ka përfunduar me datë 23.09.2019, për 1 muaj e 28 ditë. Nëse zbresim këtu lejen vjetore të muajit gusht ( çështjet me nr. 77 dhe 83) rezulton se çështjet janë gjykuar për 32 ditë, 30 ditë, 7 ditë dhe 23 ditë. Tejkalmimi me 2 ditë për njëren çështje do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë çështjet do **të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor 30 ditor.**

Për pasojë, duke konsideruar shpjegimet e mësipërme **22 çështjet e mësipërme do të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor.**

---

<sup>130</sup> Neni 291 i K. Pr. Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 30 ditë.

<sup>131</sup> Neni 332 i K. Pr. Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 30 ditë

<sup>132</sup> Neni 610 i K. Pr. Civile, ka parashikuar afatin ligjor 20 ditë.

<sup>133</sup> Neni 260 i K. Pr. Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 5 ditë.

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat dhe burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore si dhe çështjeve të analizuara më sipër, rezultoi se numri i çështjeve me afat ligjor është 552 çështje. Po ashtu në numrin e çështjeve me afat ligjor, të përfunduara tej këtij afati (140 çështje), duhet të zbriten 22 çështje, pasi referuar analizës për secilën prej tyre, rezultoi se ato duhet të konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjor. Në këtë mënyrë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (118 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (552 çështje), rezulton të jetë 21.37 %, përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 9 pikë.

Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtari ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare objekt vlerësimi (01.01.2017-31.12.2019), 2017 çështje (564 çështje në vitin 2017, 751 çështje në vitin 2018 dhe 693 çështje në vitin 2019), nga të cilat 552 çështje me afat ligjor. Pra, 27.4 % të numrit total të çështjeve kanë qenë me afat ligjor, përqindje tepër e lartë duke e ngarkuar shumë gjyqtarin me çështje që kërkonin shpejtësi. Gjithashtu, rezulton se nga numri i përgjithshëm i çështjeve, 871 çështje janë me palë kundërshtare.

Referuar standardit sasior në fuqi<sup>134</sup>, gjyqtari duhet të përfundonte jo më pak se 200 çështje me palë kundërshtare në vit, pra 600 çështje në tre vjet. Në rastin konkret, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari ka përfunduar 871 me palë kundërshtare, ose 290.3 çështje në vit nga 200 çështje që është e përcaktuar në Vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010 të ish-KLD-së, duke e kaluar standardin sasior me 90.3 çështje apo me 45 %.

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin *“Respektimi i afateve ligjore”* në shkallë shumë të lartë, duke u shprehur se *“Nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit, pra nga data 01.01.2017-31.12.2019 kam gjykuar 2013 çështje. Totali i dosjeve të përfunduara në vitin 2017 janë 564 dhe përfunduara jashtë afatit ligjor janë vetëm 86, në vitin 2018 janë 756 dhe përfunduara jashtë afatit janë vetëm 82 dhe në vitin 2019 janë 693*

---

<sup>134</sup> Në vendimin nr. 261/2, viti 2010, të ish KLD-së, lidhur me standardin sasior, në pikën 3, shkronja g), parashikohet se *“Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë që nuk është organizuar në seksione, si relator, jo më pak se 200 gjykime çështje, penale (krime dhe kundravajtje) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare”*.

*dhe përfunduara jashtë afatit janë vetëm 175. Vazhdimisht jam përpjekur që të respektoj afatet ligjore brenda të cilës duhet të përfundojë gjykimi i një çështje, por njëkohësisht duke i dhënë përparësi edhe garantimit të të drejtave të palëve ndërgjyqëse si dhe kryerjes së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, me qëllimin e vetëm zgjidhjen e drejtë të çështjes. Gjithashtu, dëshiroj të vë në dukje se seancat gjyqësore nuk janë shtyrë për shkaqe që lidhen me mua si gjyqtar i çështjes, duke qenë gjithmonë i pranishëm në punë dhe duke mos munguar pothuajse asnjë ditë. Tjetër fakt që dua të theksoj është se në shumë raste afati ka kaluar vetëm disa ditë....”*

## **KONKLuzioni**

*Në tërësi*, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, përjashtohen çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (*deri në 2 ditë*) si dhe zbritet koha gjatë se cilës gjyqtari ka kryer lejen vjetore, atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 118 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (118 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (552 çështje), rezulton të jetë **21.37 % të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor**, përqindje që sipas Metodologjisë vlerësohet me 9 pikë. Por për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara në tejkalim të afatit ligjor, që rezultojnë në masën 21.37%, duke e tejkaluar me 1.37 %, përqindjen prej 11-20% , që i korespondon pikëzimit me 12 pikë; (ii) ngarkesën e gjyqtarit si relatore (*në total për tre vite ka gjykuar 2017 çështje, nga të cilat 27.4 % apo 552 çështje janë me afat ligjore*) , duke gjykuar mesatarisht rreth 669 çështje në vit nga të cilat 184 janë me afat ligjore dhe (iii) aspektet që lidhen me kushtet e punës, konkretisht angazhimin si anëtar të trupa gjykues, kohën që gjyqtari kalon në zhvillimin e seancave, gjyqtari për këtë tregues duhet të vlerësohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që i korespondon të dhënave statistikore, duke arritur deri në pikëzimin maksimal prej 15 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Respektimi i afateve ligjore” është e lartë, brenda marzhit “0-10 %”, dhe pikëzohet me 15 pikë.*

### **2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej 1465 çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor (354 çështje në vitin 2017, 628 çështje në vitin

2018 dhe 483 çështje në vitin 2019), të cilat i përkasin kategorive të çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Familjare pa palë kundërshtare”, “Marrëdhënie pune”, “Penale krime”, “Penale kundërvajtje” dhe “Seanca paraprake-kërkesa për pushimin e procedimit penal” për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD përcakton këto standarde minimale kohore për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë, si vijon:

- jo më tej se 6 muaj (180 ditë) për gjykimet civile të themelit;
- jo më tej se 4 muaj (120 ditë) për gjykimet familjare;
- jo më tej se 9 muaj (270 ditë) për krimet me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet dhe 12 muaj (365 ditë) për krimet me minimumin e dënimit jo më pak se 10 vjet;
- jo më tej se 4 muaj (120 ditë) për kundërvajtjet penale;
- jo më tej se 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- jo më tej se 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 1465 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 347 prej tyre ose **23.6 % janë gjykuar tej standardit minimal kohor në fuqi.**

Lidhur me analizën logjike të të dhënave dhe përjashtimin e rrethanave që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, referuar edhe standardeve të zbatuara në vlerësimet e gjyqtarëve, gjejnë mbështetje në Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve, këto vlerësime;

**Së pari**, standardet minimale kohore nuk janë afate të arsyeshme. Ato nxisin gjyqtarin të jetë sa më produktiv, pavarësisht ngarkesës në punë. Standardet orientuese janë indikator matës i performancës së gjyqtarit. Ndërsa qëllimi i afateve të arsyeshme nuk është përcaktimi në mënyrë taksative i afateve të arsyeshme të gjykimit të çështjeve për gjyqtarin në vetvete, por si afate maksimale për përfundimin e tyre, shkelja e të cilave legjitimon kërkuesin palë në proces që të kërkojë dëmshpërblim.

**Së dyti**, afatet e përcaktuara me vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së për përfundimin e çështjeve (civile apo penale) kanë qenë dhe ende janë afate orientuese në funksion të menaxhimit dhe efikasitetit të çështjeve gjyqësore nga ana e gjyqtarit. Këto afate orientuese shërbejnë si një standard matës për efekt të vlerësimit të gjyqtarëve, nëse ata në punën e tyre kanë ndërmarrë një rol të vëmendshëm në planifikimin e seancave gjyqësore dhe në sigurimin e administrimit efikas të seancave gjyqësore, e për rrjedhojë të përfundimit të çështjeve në një kohë sa më të shkurtër. Nga ana tjetër, tejkalimi i këtyre afateve orientuese, nuk nënkupton shkeljen e standardit të procesit të rregullt ligjor parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 të KEDNJ-së

**Së treti**, afatet e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale të detyrueshme për tu zbatuar (*njoftimi i deklaratës së mbrojtjes, njoftimi me shpallje për palët...etj.*), apo edhe ato opsionale për tu zbatuar (*shpallja e arsytuar e vendimit, etj.*) llogariten në afatin standard orientues të gjykimit të çështjes. Standardet orientuese përfshijnë në vetvete edhe kohën që i

duhet gjyqtarit për kryerjen e veprimeve procedurale, të tilla si: shtyrjen deri në 20 ditë për shpallje të arsyetuar të vendimit; shtyrjen deri në tre ditë për tu shprehur në lidhje me kërkesat e palëve ; respektimin e afatit 30/ditor për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes ; afatit 20/ditor për njoftimin e palëve me shpallje, afati 5/ditor për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim (neni 302/2 i K.Pr.Civile) etj.

**Së katërti**, afatet të cilat nuk janë në funksion të procesit (si p.sh. afati 35 ditë në muajin Gusht - leja vjetore) apo afatet të cilat ecin për shkak të disa veprimeve procedurale (si p.sh. koha e kaluar nga pezullimi i çështjes deri në rifillimin e saj, koha e kaluar nga data e ankimit të një vendimi të ndërmjetëm, faza e parë e pjesëtimit, ankim ndaj pezullimit të çështjes, parashtrimi i konfliktit të kompetencës Gjykatës së Lartë, etj.), janë afate, të cilat nuk duhet të llogariten në afatin orientues, pasi ato nuk ecin jo për shkak të menaxhimit jo të mire të çështjes nga ana e gjykatës. Në këtë kontekst, këto afate nuk duhet të llogariten në kohëzgjatjen e gjykimit, për aq sa rezultojnë të referuara nga ana e gjyqtarit për çështje konkrete apo nga të dhënat e pasqyruara në tabelat statistikore. Po kështu duhet mbajtur në vëmendje edhe caktimi i gjyqtarit si relator i çështjes, në ato raste kur çështja është shortuar pas dhënies së dorëheqjes apo përjashtimit të gjyqtarëve të tjerë. Në rastin konkret nuk rezulton që gjyqtari të ketë referuar të dhëna për kohën e pezullimit, kthimit të çështjes për vijimin e hetimeve, etj., për çështje konkrete, duke pamundësuar identifikimin dhe analizën e këtyre çështjeve. Për pasojë, në rastin konkret, duke iu referuar tabelave me të dhëna statistikore, e vetmja e dhënë objektive që rezulton është kohëzgjatja e gjykimit diktuar nga leja vjetore në muajin gusht, e cila do të analizohet dhe zbritet në çështjet respektive.

Në përlllogaritjen e standardit minimal kohor, për të gjitha dosjet, përlllogaritja e afateve do të fillojë nga data e shortimit (pra, data kur çështja ka shkuar pranë gjyqtarit), dhe jo ajo e regjistrimit. Në të gjitha dosjet, në përlllogaritje do të zbriten:

- leja vjetore e muajit gusht prej 35 ditësh (ligji parashikon 25 ditë pune apo 5 javë kalenderike për gjyqtarët);
- festat e fundvitit dhe afati i mbartjes së dosjeve 6 ditë ;

Duke mbajtur në konsideratë analizën e sipërcituar, vlerësohet që të konsiderohen si çështje të cilat kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor çështjet si më poshtë:

- për vitin 2017
  - (i) në tabelën nr. 1, çështjet civile me palë kundërshtare me nr. rendor 3, 9, 61 dhe 62, janë gjykuar për 6 muaj e 28 ditë, 6 muaj e 29 ditë, 6 muaj e 5 ditë dhe 6 muaj e 17 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, rezulton që çështjet janë gjykuar për 5 muaj e 23 ditë, 5 muaj e 24 ditë, 5 muaj dhe 5 muaj e 12 ditë, pra, **brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj (180 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
  - (ii) Në tabelën nr. 2, çështja civile pa palë kundërshtare me nr. rendor 84 është gjykuar për 2 muaj e 2 ditë. Tejkalmimi i afatit deri me 2 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështja do të konsiderohet e gjykuar **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

- (iii) Në tabelën nr. 3, çështjet familjare me palë kundërshtare me nr. rendor 40, 44 dhe 47 janë gjykuar për 4 muaj e 2 ditë, 4 muaj e 6 ditë dhe 4 muaj e 25 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes lejen vjetore të muajit gusht, çështjet rezultojnë të gjykuara për 2 muaj e 27 ditë, 3 muaj e 1 ditë dhe 3 muaj e 20 ditë, pra ***brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj (120 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
  - (iv) Në tabelën nr. 4, çështjet familjare pa palë kundërshtare me nr. rendor 1, 9, 13 dhe 16 janë gjykuar për 2 muaj e 5 ditë, 2 muaj e 1 ditë, 3 muaj dhe 2 muaj e 5 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes lejen vjetore të muajit gusht, çështja me nr. rendor 13 rezulton e gjykuar për 1 muaj e 25 ditë. Tejkalmimi i afatit deri me 5 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
  - (v) Në tabelën me nr. 9, çështjet penale kundravajtje me nr. rendor 6 dhe 8, është gjykuar për 4 muaj e 13 ditë dhe 4 muaj e 9 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjeve kohën e festave të fundvitit dhe mbartjen e dosjeve, rezulton se çështjet janë gjykuar për 4 muaj e 7 ditë dhe 4 muaj e 3 ditë. Tejkalmimi i afatit deri me 7 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara ***brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj (120 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
  - (vi) në tabelën nr. 12, çështja kërkesë penale të fazës së ekzekutimit, me nr. rendor 10 është gjykuar në afatin 3 muaj e 6 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes lejen vjetore të muajit gusht, çështja rezulton e gjykuar për 2 muaj e 1 ditë. Tejkalmimi i afatit me 1 dite do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështja do të konsiderohet e gjykuar ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- për vitin 2018
- (vii) në tabelën nr. 1, çështjet civile me palë kundërshtare me nr. rendor 1, 27, 33 dhe 62, janë gjykuar për 7 muaj e 5 ditë, 6 muaj e 6 ditë, 6 muaj e 12 ditë dhe 6 muaj e 28 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht (nr. 1, 62) kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve (nr. 27, 33) rezulton që çështjet janë gjykuar për 5 muaj e 24 ditë, 6 muaj, 6 muaj e 6 ditë dhe 5 muaj e 23 ditë. Tejkalmimi i afatit me 6 ditë për një nga çështjet do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara ***brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj (180 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
  - (viii) Në tabelën nr. 2, çështja civile pa palë kundërshtare me nr. rendor 19, 288, 302 dhe 353 janë gjykuar për 2 muaj e 1 ditë, 2 muaj e 26 ditë, 3 muaj e 9 ditë dhe 2 muaj e 29 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve (nr. 19) dhe kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht (nr. 288, 302, 353 ), rezulton që çështjet janë gjykuar për 1 muaj e 26 ditë, 1 muaj e 21 ditë, 2 muaj e 4 ditë dhe 1 muaj e 24 ditë. Tejkalmimi i afatit deri me 4 ditë për një çështje do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
  - (ix) Në tabelën nr. 3, çështjet familjare me palë kundërshtare me nr. rendor 1, 2, 15, 17, 49, 51 dhe 59 janë gjykuar për 4 muaj e 4 ditë, 4 muaj e 11 ditë, 4 muaj e 7 ditë, 4 muaj e 3 ditë, 4 muaj e 11 ditë, 4 muaj e 1 ditë dhe 4 muaj e 30 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve (1, 2, 15, 17) apo lejen vjetore të muajit gusht (nr. 49, 51, 59), çështjet rezultojnë të gjykuara për

3 muaj e 28 ditë, 4 muaj e 5 ditë, 4 muaj e 1 ditë, 3 muaj e 27 ditë, 3 muaj e 6 ditë, 2 muaj e 26 ditë dhe 3 muaj e 25 ditë. Tejkalimi i afatit deri në 5 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohet të gjykuara **brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj (120 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

(x) Në tabelën nr. 4, çështja familjare pa palë kundërshtare me nr. rendor 12 është gjykuar për 2 muaj e 4 ditë. Tejkalimi i afatit deri me 4 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështja do të konsiderohet e gjykuar **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

(xi) në tabelën me nr. 8, çështje me objekt vepra penale që dënohen deri në 10 vjet burgim, çështja me nr. rendor 18 është gjykuar për 9 muaj e 25 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, çështja rezulton e gjykuar për 8 muaj e 20 ditë, **brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj (180 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

(xii) në tabelën nr. 9, çështjet kundravajtje penale me nr. rendor 7 dhe 10 janë gjykuar për 4 muaj e 5 ditë dhe 4 muaj e 4 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes (nr.10) lejen vjetore të muajit gusht, çështjet rezultojnë të gjykuara për 4 muaj e 5 ditë dhe 2 muaj e 29 ditë. Tejkalimi i afatit me 5 dite për njëren çështje do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara **brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj (120 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

(xiii) në tabelën nr. 11, çështjet me nr. rendor 40 dhe 52, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 2 muaj e 13 ditë dhe 2 muaj e 3 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes lejen vjetore të muajit gusht (nr.40), çështjet rezultojnë të gjykuara për 1 muaj e 8 ditë dhe 2 muaj e 3 ditë. Tejkalimi i afatit me 3 dite për njëren çështje do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

(xiv) në tabelën nr. 12, çështjet me nr. rendor 1, 6 dhe 10 janë gjykuar për 2 muaj e 6 ditë, 2 muaj e 2 ditë dhe 3 muaj e 6 ditë. kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve (nr.1) apo lejen vjetore të muajit gusht (nr. 10), çështjet rezultojnë të gjykuara për 2 muaj, 2 muaj e 2 ditë dhe 2 muaj e 1 ditë. Tejkalimi i afatit me 2 dite do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

- për vitin 2019

(xv) në tabelën nr. 1, çështjet civile me palë kundërshtare me nr. rendor 16, 38, 49, 50 dhe 77 janë gjykuar për 7 muaj e 10 ditë, 6 muaj e 7 ditë, 6 muaj e 1 ditë, 6 muaj e 1 ditë dhe 6 muaj e 7 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve (nr.38) si dhe lejen vjetore të muajit gusht (nr.17, 77), rezulton që çështjet janë gjykuar për 5 muaj e 29 ditë, 6 muaj e 1 ditë, 6 muaj e 1 ditë, 6 muaj e 1 ditë dhe 5 muaj e 2 ditë. Tejkalimi i afatit me 1 dite për njëren çështje do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara **brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj (180 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

(xvi) Në tabelën nr. 3, çështjet familjare me palë kundërshtare me nr. rendor 7, 18, 48, 50, 56, 82, 85, 96, 97, 98, 101, 109, 110, 116, 120, 139 dhe 141 janë gjykuar për 4 muaj e 11 ditë, 4 muaj e 8 ditë, 4 muaj e 5 ditë, 4 muaj e 12 ditë, 4 muaj e 3 ditë, 4 muaj e 4 ditë, 4 muaj e 6 ditë, 4 muaj e 28 ditë, 4 muaj e 20 ditë, 4 muaj e 9 ditë, 4 muaj e 20 ditë, 4 muaj e 23 ditë, 5 muaj e 8 ditë, 4 muaj e 10 ditë, 4 muaj e 12 ditë, 5 muaj e 11 ditë dhe



5 muaj e 6 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve (çështja nr. 7, 18, 48, 50 ) apo lejen vjetore të muajit gusht (nr. 96, 97, 98, 101, 109, 110, 116, 120, 139 ) çështjet rezultojnë të gjykuara për 4 muaj e 5 ditë, 4 muaj e 2 ditë, 3 muaj e 29 ditë, 4 muaj e 6 ditë, 4 muaj e 3 ditë, 4 muaj e 4 ditë, 4 muaj e 6 ditë, 3 muaj e 23 ditë, 3 muaj e 15 ditë, 3 muaj e 4 ditë, 3 muaj e 15 ditë, 3 muaj e 18 ditë, 4 muaj e 3 ditë, 3 muaj e 5 ditë, 3 muaj e 7 ditë, 4 muaj e 4 ditë. Tejkalmimi i afatit deri me 6 dite për disa nga çështjet do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara **brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj (120 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

(xvii) Në tabelën nr. 4, çështjet familjare pa palë kundërshtare me nr. rendor 10, 21, 23 dhe 28 janë gjykuar për 2 muaj e 6 ditë, 2 muaj e 29 ditë, 2 muaj e 9 ditë dhe 3 muaj e 2 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes lejen vjetore të muajit gusht (nr.21, 23, 28), çështjet rezultojnë të gjykuara për 2 muaj e 6 ditë, 1 muaj e 24 ditë, 1 muaj e 4 ditë dhe 1 muaj e 27 ditë. Tejkalmimi i afatit deri me 6 ditë për një tërësi çështje do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

(xviii) në tabelën nr. 9, çështja kundravajtje penale me nr. rendor 15 është gjykuar për 4 muaj e 14 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes lejen vjetore të muajit gusht, çështja rezulton e gjykuar për 3 muaj e 9 ditë, pra **brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj (120 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

(xix) në tabelën nr. 11, çështjet me objekt pushim çështje, me nr. rendor 17, 82, 84, 86 dhe 88, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 2 muaj e 2 ditë, 2 muaj e 28 ditë, 2 muaj e 16 ditë, 2 muaj e 4 ditë dhe 3 muaj e 11 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve (nr. 17) apo lejen vjetore të muajit gusht (nr. 82, 84, 86, 88), çështjet rezultojnë të gjykuara për 1 muaj e 26 ditë, 1 muaj e 23 ditë, 1 muaj e 11 ditë, 29 ditë dhe 2 muaj e 6 ditë. Tejkalmimi i afatit deri me 6 ditë për një tërësi çështje do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

(xx) në tabelën nr. 12, çështja me nr. rendor 14 është gjykuar në afatin 2 muaj e 18 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes lejen vjetore të muajit gusht, çështja rezulton e gjykuar për 1 muaj e 13 ditë, pra **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

Pra, janë gjithsej 71 çështje që do të llogariten të gjykuara brenda standardit minimal kohor dhe do t'i zbriten numrit prej 347 çështjesh të përlllogaritura në raportin analitik, duke mbetur kështu 276 çështje.

Duke konsideruar sa më sipër, numri total i çështjeve për të cilat parashikohet standardi minimal kohor është 1465 dhe numrit total të çështjeve të përfunduara jashtë standardit minimal kohore cila nuk është më 347, por rezulton të jetë 276 çështje, ose 18.8 % e numrit total të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor. Sipas “*Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit*”, të miratuar me vendimin

me Nr. 264, datë 21.11.2019 të KLGJ, përqindja matematikore prej 18.8 % përkon me nivelin e vlerësimit 4 (katër) pikë (10-20% - 4 pikë).

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, në përcaktimin e nivelit të vlerësimit për këtë tregues, të dhënat statistikore analizohen duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës së gjyqtarit.

Referuar treguesit sasior, rezultoi se gjyqtari ka përfunduar në periudhën 3 vjeçare të vlerësimit në total 2017 çështje nga të cilat 871 çështje me palë kundërshtare (*civile të përgjithshme, familjare, marrëdhënie pune, penale krime, penale kundërvajtje dhe kërkesa për pushim procedimi*). Referuar standardit sasior në fuqi<sup>135</sup>, gjyqtari duhet të përfundonte jo më pak se 200 çështje me palë kundërshtare në vit, pra 600 çështje në tre vjet. Ndërkohë rezultoi se ai ka përfunduar 871 çështje me palë kundërshtare, duke tejkaluar këtë standard me 271 çështje në periudhën tre vjeçare, ose në masën 45.1 %.

Gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivel maksimal duke u shprehur se “*Nga të dhënat statistikore rezultoi se gjatë periudhës së vlerësimit, pra nga data 01.01.2017-31.12.2019 kam gjykuar 2013 çështje. Po sipas të dhënave statistikore, rezultoi se vetëm 175 çështje janë përfunduar jashtë standartit minimal kohor. Vazhdimisht jam përpjekur që të respektoj standartet minimale kohore brenda të cilës duhet të përfundojë gjykimi i një çështje, por njëkohësisht duke i dhënë përparësi edhe garantimit të të drejtave të palëve ndërgjyqëse si dhe kryerjes së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, me qëllimin e vetëm zgjidhjen e drejtë të çështjes. Gjithashtu, dëshiroj të vë në dukje se seancat gjyqësore nuk janë shtyrë për shkaqe që lidhen me mua si gjyqtare e çështjes, duke qenë gjithmonë e pranishme në punë dhe duke mos munguar pothuajse asnjë ditë. Tjetër fakt që dua të theksoj është se në shumë raste afati ka kaluar vetëm disa ditë.*”

## KONKLuzioni

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit minimal kohor (276 çështje), me numrin total të çështjeve për të cilat zbatohen standartet minimal (1465 çështje) që rezultoi 18.8 %; (ii) faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit referuar shkaqeve të bëra prezent nga gjyqtari në vetëvlerësimin e tij, të cilat përgjithësisht nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit dhe (iii) tejkalimin e standardit sasior të zbatueshëm në masën 45.1 %, (iv) numrin e lartë të çështjeve të gjykuara brenda 3 vjetëve, prej 2017 çështje, nga të cilat 552 çështje ose 27.4 % e tyre

---

<sup>135</sup> Në vendimin nr. 261/2, viti 2010, t ish KLD-së, lidhur me standardin sasior, në pikën 3, shkronja g), parashikohet se “*Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë që nuk është i organizuar në seksione, si relator, jo më pak se 200 çështje penale (krime dhe kundërvajtje) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje me palë kundërshtare.*”.

kanë qenë me afat ligjore, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” vlerësohet se gjyqtari duhet të pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 18.8 % të çështjeve jashtë standardit minimal kohor, ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, sikundër është treguesi sasior i punës së tij (tejkallim i standardit sasior me 45.1 %).*

### **2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.**

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është si më poshtë:

- i. Në kategorinë e çështjeve “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 230 ditë (7 muaj e 20 ditë), pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- ii. Në kategorinë e çështjeve “*Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 27 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- iii. Në kategorinë e çështjeve “*Familjare me palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 88 ditë (2 muaj e 28 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- iv. Në kategorinë e çështjeve “*Familjare pa palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 59 ditë (1 muaj e 29 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej 2 muaj;
- v. Në kategorinë e çështjeve “*Marrëdhënie pune*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 99 ditë (3 muaj e 9 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- vi. Në kategorinë e çështjeve “*Penale-krime*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 80 ditë (2 muaj e 20 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 9 apo 12 muaj;
- vii. Në kategorinë e çështjeve “*Penale-kundërvajtje*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 65 ditë (2 muaj e 5 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- viii. Në kategorinë e çështjeve “*Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 108 ditë (3 muaj e 18 ditë), pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;

- ix. Në kategorinë e çështjeve “*Seancë paraprake*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 53 (1 muaj e 23 ditë) ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- x. Në kategorinë e çështjeve “*Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 90 ditë (3 muaj), pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara është më e shkurtër se standardi për shumicën e kategoritë e çështjeve, duke u tejkualuar standardi kohor minimal i gjykimit, tek çështjet “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, “*Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak*” dhe tek çështjet “*Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”, ku koha mesatare është tejkualuar përkatësisht me 1 muaj e 20 ditë, 1 muaj e 18 ditë dhe me 1 muaj. Referuar metodologjisë së Pikëzimit, kjo llogaritje matematikore përkon me një pikëzim prej 4 pikësh.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari, e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin në shkallë shumë të lartë duke theksuar se: “*Siç e citova më sipër, kam përfunduar 2013 çështje dhe kam arritur të respektoj afatet e gjykimit, arsytimit dhe dorëzimit të vendimeve. Në çdo rast jam përpjekur dhe kam kryer çdo veprim të mundshëm për të përfunduar gjykimin e çështjeve brenda afatit. Përveç sa kam parashtruar në rubrikat e mësipërme, vë në dukje edhe ngarkesën e lartë me çështje të natyrave të ndryshme, zhvillimi i shumë seancave gjyqësore në ditë dhe çdo ditë të javës, delegime nëpër gjykata të ndryshme.*”

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.<sup>136</sup> Pra edhe për këtë tregues, vlen të analizohen shkaqet që kanë çuar në përfundimit të çështjeve tej standard minimal kohor, për të shmangur shkaqet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, ashtu si tek treguesi “Plotësimi i standardeve minimale kohore”. Kështu, referuar treguesit sasior, rezultoi se gjyqtari ka përfunduar në periudhën 3 vjeçare të vlerësimit në total 2017 çështje nga të cilat 871 çështje me palë kundërshtare (*civile të përgjithshme, familjare, marrëdhënie pune, penale krime, penale kundërvajtje dhe kërkesa për pushim procedimi*) duke tejkualuar standardin me 271 çështje në periudhën tre vjeçare, ose në masën 45.1 %.

## KONKLUZIONI

Referuar sa më sipër, duke qenë se shumicën e kategorive të çështjeve (7 nga 10 kategori), koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, llogaritje e cila sipas Metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 4 pikë. Por duke marrë në konsideratë volumin e çështjeve, ku gjatë

---

<sup>136</sup> Metodologjia e Pikëzimit për këtë tregues parashikon se : “...Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal”.

periudhës 3 vjeçare, gjyqtari ka dhënë 2017 vendime, nga të cilat 871 janë çështje me palë kundërshtare, angazhimin e gjyqtarit në trupa gjykues, caktimin e tij si relator apo si anëtar i trupit gjykues në gjykata të tjerë, ku gjatë vitit 2017 është angazhuar në 25 çështje, vlerësohet që niveli i vlerësimit duhet të jetë më i lartë se ai që i korespondon pikëzimit të përcaktuar në tabelën përkatëse, duke arritur në pikëzimin maksimal.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje duhet të konsiderohet më e shkurtër me standardin minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

### **2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (2017 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (2038 çështje) brenda periudhës 3/vjeçare të vlerësimit, **është 99 %** përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 5 pikë, duke qenë se rezultojnë +99%.

E ndarë në vite, rendimenti rezultojnë si më poshtë;

Për vitin 2017 i janë caktuar 529 çështje dhe ka përfunduar 564 çështje, pra 106.6 %;

Për vitin 2018 i janë caktuar 806 çështje dhe ka përfunduar 751 çështje, pra 93.2 %

Për vitin 2019 i janë caktuar 703 çështje dhe ka përfunduar 693 çështje, pra 98,6 %.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin mesatar. Ndër të tjera gjyqtari thekson: “Ky vetëvlerësim është argumentuar si vijon: “*Duke patur parasysh ngarkesën në punë dhe faktorët e tjerë që kanë të bëjnë me mungesën e justifikuar apo të pajustificuar të avokatëve, prokurorëve, palëve ndërgjyqëse, ekspertëve apo dëshmitarëve apo mungesës së bashkëpunimit të institucioneve zyrtare si Zyrave shtetërore në respektimin e detyrimeve ligjore në kthimin e përgjigjeve zyrtare, mendoj se ja kam arritur me sukses të ruaj afatet e përfundimit të gjykimit të çështjeve. Sipas të dhënave rezultojnë se aftësia për përfundimin e çështjeve gjyqësore është shumë e lartë, duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve të përfunduara me numrin e çështjeve që janë caktuar brenda një viti kalendarik.”.*

### **KONKLuzioni**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, meqenëse rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezultojnë në masën 99 %, gjyqtari për këtë tregues duhet të vlerësohet dhe pikëzohet në nivelin maksimal (+ 99 %- 10 pikë).

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: : Referuar sa më sipër, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë dhe gjyqtari të pikëzohet 10 pikë, pasi rezulton me një rendiment +99 %.*

#### **2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

- i. Për të gjitha çështjet e kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsyetimit është 4.5 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- ii. Për çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsyetimit është 4 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- iii. Për çështje të kategorisë “*familjare me palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsyetimit është 4 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- iv. Për çështje të kategorisë “*familjare pa palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsyetimit është 6 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- v. Për çështje të kategorisë “*marrëdhënie pune*”, koha mesatare e arsyetimit është 5 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- vi. Për çështje të kategorisë “*krime*”, koha mesatare e arsyetimit është 4 ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.
- vii. Për çështje të kategorisë “*kundravajtje*”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 4 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale
- viii. Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:
  - Për kërkesa me objekt vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi, 3 ditë, pra më e **shkurtër** se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K.Pr.Penale.
  - Për kërkesa me objekt caktim mase sigurimi, koha mesatare e arsyetimit është 3 ditë, pra më e **gjatë** se afati procedural i parashikuar nga neni 244/1 i K.Pr.Penale, i cili kërkon që vendimi të jepet i arsyetuar.
  - Për kërkesa me objekt verifikim i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit, **përfaërsisht** 2 ditë, pra sa afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 248 i K.Pr.Penale.
  - Për kërkesa me objekt zëvendësim/revokim mase sigurimi, 2 ditë, pra më e **shkurtër** se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit,

referuar nenit 249 i K.Pr.Penale.

- Për kërkesa me objekt shuarje mase sigurimi, 2,5 ditë, pra më e **gjatë** se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 261/3 dhe 248/2 i K. Penal.
  - Për kërkesa me objekt lejim përgjimi/zgjatje afat përgjimi, 1 ditë, pra **sa afati** procedural 24 orë i parashikuar nga neni 222 i K.Pr.Penale.
  - Për kërkesa me objekt kontroll banese, 1 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural i parashikuar nga neni 202/a i K.Pr.Penale, i cili kërkon që vendimi të jepet i arsyetuar.
  - Për kërkesa me objekt sigurim prove, 3 ditë, pra më e **shkurtër** se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 320 të K.Pr.Penale.
  - Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 3 ditë, pra më e **shkurtër** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.
- ix. Për çështje të kategorisë “*seancë paraprake*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:
- Për çështje me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, 5 ditë, pra më e **shkurtër** se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh i K.Pr.Penale.
  - Për çështje për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 4 ditë, pra më e **shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.
- x. Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:
- Për kërkesa me objekt shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 3 ditë, pra më e **shkurtër** se afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 476 i K.Pr.Penale.
  - Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 4 ditë, pra më e **shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.

Nga 9 (nëntë) nën kategoritë e kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, vetëm në 3 prej tyre, koha mesatare e arsyetimit e ka tejkaluar afatin procedura. Nga të dhënat statistikore, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit është tejkaluar në nënkategoritë e çështjeve me objekt “*çaktim mase sigurimi*”, duke e tejkaluar këtë afat me 1 ditë, “*shuarje mase sigurimi*”, duke tejkaluar këtë afat me 0.5 ditë apo me disa orë dhe “*kontroll banese*”, e cila është dorëzuar ditën tjetër, çka mund të ketë ndikuar mënyra se si administrohet regjistri i dorëzimit të vendimit e për pasojë do të konsiderohet se është dorëzuar në kohë.

Sa më sipër, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar, është më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve, që sipas Metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 12

pikë.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në shkallë mbi mesataren duke theksuar se *“Për vitet 2017–2019 kam përfunduar 1973 çështje nga 2073 çështje që kam patur për gjykim pra 95.17 % të tyre, pavarësisht ngarkesës në punë. Përsa i përket arsyetimit të vendimeve parashtraj se pjesa më e madhe e tyre është arsyetuar dhe dorëzuar brenda afatit. Gjithsesi, duhet të theksoj se për shkak të ngarkesës së lartë në punë, ku ka patur raste që mund të kem shpallur deri në 6 vendime në ditë; kompleksitetit të disa çështjeve, volumin e tyre etj. ky afat mund të ketë kaluar, por pa cënuar në asnjë rast të drejtën e palëve për ankim etj. apo kaluar afatin maksimal 1–muaj.”*

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Në rastin konkret, lidhur me këtë tregues duke pasur në konsideratë, volumin e çështjeve ku rezultoi se për një periudhë tre vjeçare (2017-2019), gjyqtari ka dhënë 2017 vendime, mesatarisht rreth 672 vendime në vit, apo rreth 61 vendime në muaj, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, konkretisht kohën angazhimit të gjyqtarit në gjykimet gjatë orarit zyrtar në ditët e javës, angazhimin e tij si anëtar i trupit gjykues, vlerësohet që për këtë tregues gjyqtari të vlerësohet në një nivel më të lartë pikëzimi, që i korespondon pikëzimit maksimal prej 15 pikë.

## **KONKLuzioni**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si *“Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”* dhe gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin *“Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar”* vlerësohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimit duhet të konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, e për këtë arsye gjyqtari pikëzohet me 15 pikë.*

## **2.B AFTËSIA PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE.**

**2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.**



Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se të dhënat e evidentuara në tabelat statistikore nuk mund të përdoren pasi përmbajnë në tërësi numrin e seancave përgatitore dhe gjyqësore për çdo çështje (të natyrës civile). Rrjedhimisht, nuk mund të evidentohet numri i seancave gjyqësore. Për pasojë, të dhënat për vlerësimin e këtij treguesi i referohen numrit të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Referuar të dhënave të analizuara në Raportin analitik, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, duke përfshirë ato pa palë kundërshtare, rezulton si më poshtë:

- (i) për kategorinë e çështjeve "*Penale themeli*", është 2 (dy) seanca gjyqësore.
- (ii) për kategorinë e çështjeve/kërkesave "*Seanca paraprake*", "*dërgim çështje në gjyq*" dhe "*pushim procedimi penal*", është 2 (dy) seanca gjyqësore.
- (iii) për kategorinë e çështjeve "*Familjare me palë kundërshtare*", 3 (tre) seanca gjyqësore.
- (iv) për kategorinë e çështjeve "*Civile me palë kundërshtare*", është 2.6 (dy presje gjashtë) seanca gjyqësore.

Në kategorinë "*Penale themeli*" janë zhvilluar 6 seanca gjyqësore; në kategoritë "*Seanca paraprake*", "*dërgim çështje në gjyq*" dhe "*pushim procedimi penal*" janë zhvilluar 8 seanca gjyqësore; në kategorinë "*Civile me palë kundërshtare*" janë zhvilluar 13 seanca gjyqësore dhe në kategorinë "*Familjare me palë kundërshtare*" janë zhvilluar 18 seanca gjyqësore. Pra, për 18 gjykime janë zhvilluar 45 seanca gjyqësore.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore, për të gjitha çështjet me palë kundërshtare, rezulton të jetë **2.5 seanca gjyqësore**.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtari ka kryer në mënyrë efektive veprimet për vënien në lëvizje të çështjes, ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Konstatohet nga aktet në dosjet burim vlerësimi se gjyqtari për çdo çështje ka disponuar me urdhër ose vendim për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes, duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë akt urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kritereve të parashikuara në K.Pr.Civile, sipas K.Pr.Penale në çështjet penale, duke urdhëruar kryerjen e njoftimeve për palët dhe marrjen e masave për të siguruar prezencën apo shoqërimin e të pandehurve.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme procedurale të tilla si: në kushtet e mosmarrjes dijeni të palëve ndërgjyqëse, me qëllim përsëritjen e njoftimit për të pandehurit të cilët nuk janë paraqitur; me qëllim shoqërimin e detyrueshëm për të pandehurit të cilët

rezultoi të mos paraqiteshin, me qëllim njoftimin e avokatit të caktuar kryesisht, përsëritjen e njoftimit palëve ndërgjyqëse, mbi kërkesën e palës paditëse për shtyrjen e seancës, për shkak të mosparaqitjes së gjyqtarit për arsye familjare, për t'i dhënë kohë palës paditëse të sjellë provat shkresore në formën e kërkuar nga ligji, për të bërë të mundur paraqitjen e ekspertës psikologe; për t'i dhënë mundësi ekspertës psikologe të realizojë aktin e ekspertimit, me qëllim marrjen e provave të nevojshme, me qëllim paraqitjen e diskutimeve përfundimtare.

Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe objektive, si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim. Megjithatë vihet re se në çështjet me objekt zgjidhje martesë<sup>137</sup>, gjyqtari nuk ka caktuar ekspertin psikolog në seancë përgatitore sipas parashikimit të nenit 158/b të KPRC<sup>138</sup>, por e ka caktuar në seancë gjyqësore dhe nuk ka marrë masa paraprake për sigurimin e prezencës së tij në seancën paraprakisht apo në një rast nuk ka marrë masë që akti i ekspertimit t'i njoftohet paraprakisht palëve përpara seancës së rradhës, në mënyrë që të mos zhvarritej gjykimi, për shkak të njoftimit të ekspertës apo sipas kërkesës së palëve për tu njohur me aktin e ekspertimit.

Sipas raportit analitik, në 4 çështjet e kategorisë seancë paraprake, referuar vendimit për kalimin e çështjes për shqyrtim, rezulton që gjyqtari ka caktuar datën e seancës së parë gjyqësore jashtë afatit ligjor 10 ditor të parashikuar në dispozitë neni 332/2 i K.Pr.Penale në të gjitha çështjet. Për një tërësi çështje, ku seanca e parë është lënë pas më shumë se një muaji, në zgjatjen e këtij afati kanë ndikuar leja vjetore e muajit gusht<sup>139</sup>. Megjithatë, vlerësoj se në mos respektimin e këtij afati ka ndikuar parashikimet e ndryshme të dy dispozitave të KPrP, nenit 332/2 dhe 332/a pika 3 e K.Pr.Penale të ndryshuar, ku në një vendim “për dërgimin e çështjes në gjykim” nga ana e gjyqtarit është arsyetuar tejkalimi i këtij afati për shkak të kolizionit ndërmjet dispozitave, nenit 332/2 dhe 332/a pika 3 e K.Pr.Penale të ndryshuar<sup>140</sup>. Përgjithësisht, rezulton se seancat gjyqësore janë shtyrë brenda një afati në maksimum prej 5-32 ditësh nga njëra – tjetra në çështjet civile/familjare, dhe deri në 15 ditë në çështjet penale, konform nenit 342/2 të K.Pr.Penale. Vetëm në disa raste konstatohet lënia në një kohë të gjatë e seancës, për shkak të lejes vjetore në muajin gusht, apo në fund të vitit, periudhë që përkon me procedurën e mbartjeve të dosjeve nga administrata.

---

<sup>137</sup> Çështja që i përket vendimit nr. 1264-196, datë 07.06.2018, vendimit nr. 1463-459, 16.12.2019, nr. 361-111, datë 28.03.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>138</sup> Neni 158/b paragrafi i parë parashikon se:” 1. Gjyqtari cakton detyrimisht seancën e veprimeve përgatitore në rastet kur merr në shqyrtim kërkesat për ndërhyrje kryesore, dytësore, për zëvendësim procedural, kalim procedural, ndryshimin e shkakut ose shtimin, pakësimin ose ndryshimin e objektit të padisë, paraqitjen e kundërpadisë, si dhe caktimin e ekspertit”

<sup>139</sup> Vendimi nr. 1211-323, datë 15.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

<sup>140</sup> Raporti analitik, faqe 55

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në shkallë të lartë. Gjyqtari ka parashtruar se: *“Mungesa e sistemit të saktë të adresave dhe shërbimi postar jo i mirëtrajnuar dhe profesional, mungesa e avokatëve, palëve apo ekspertëve, qoftë edhe për arsye edhe të justifikuara shëndetësore dhe në raste të veçanta e prokurorëve kanë shkaktuar shtyrje gjykimi dhe seance jo produktive. Këto janë rrethana që nuk mund të menaxhohen nga unë si gjyqtar, pavarësisht masave ligjore të marra. Përsa i përket seancave gjyqësore dhe caktimit të tyre, gjithmonë kam respektuar afatin e parashikuar nga ligji procedural dhe ligjet e veçanta duke mos i tejkaluar në asnjë rast këto afate. Gjithashtu, në caktimin e seancave pasardhëse gjithmonë kam marrë mendimin e palëve ndërgjyqëse. Në çdo rast jam përpjekur për të shmangur seancat joproduktive.”*

## **KONKLuzioni**

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin *“Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”*, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2.5 seanca dhe në çdo rast gjyqtari ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave, shkalla e aftësisë duhet të vlerësohet në nivel maksimal, duke e pikëzuar me 15 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin *“Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”*, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit është shumë e lartë dhe pikëzohet me 15 pikë.*

### **2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.**

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtari në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për kryerjen e veprimeve paraprake, pasi rezulton se pala e paditur është njoftuar rregullisht për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes, duke i lënë edhe një afat 30 ditore (por në asnjë rast në dosje nuk është vendimi apo urdhëri i arsyetuar ku të jenë përcaktuar urdhërimet përkatëse), për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve. Në të gjitha çështje civile, me palë kundërshtare, pasi kryerjes së veprimeve paraprake gjykata është shprehur me vendim për caktimin e seancës përgatitore, e cila përmban urdhërimin e sekretarisë për planifikimin e seancës përgatitore dhe urdhërimin e njoftimit të palëve për këtë datë, por pa e arsyetuar vendimin pse është i nevojshëm caktimi i seancës përgatitore sipas kriterëve të parashikuara në nenin 158/b K.Pr.Civile. Kodi i Procedurës Civile, me ndryshimet e bëra me ligjin nr.38/2017 ka

parashikuar mundësinë që pas kryerjes së veprimeve paraprake sipas nenit 158 të KPRC, gjykata mund ta kalojë direkt çështjen në seancë gjyqësore, përveç rasteve kur është e nevojshme sipas nenit 158/b të KPRC, çka nënkupton se gjyqtari duhet të arsyetoj rrethanat që e bëjnë të nevojshme caktimin e seancës përgatitore.

Ndërsa tek çështjet me objekt zgjidhje martesë, gjyqtari ka disponuar me vendim për caktimin e seancës së pajtimit, duke urdhëruar planifikimin e seancës si dhe urdhërimin e njoftimit të palëve. Pas zhvillimit të seancës së pajtimit, gjyqtari ka disponuar me vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, pra pa caktuar dhe zhvilluar seancë përgatitore sipas nenit 158/b të KPRC, të ndryshuar me ligjin nr.38.2017 (në fuqi në kohën e paraqitjes së padisë), megjithëse nga ana e gjykatës është vlerësuar e nevojshme marrja e provës me ekspert, i cili më pas është caktuar në seancë gjyqësore. Pas zhvillimit të seancës së pajtimit, gjykata ka disponuar me vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, urdhër i cili jo gjithmonë është nxjerrë i arsyetuar dhe nuk i është njoftuar palëve sipas nenit 158/c të K.Pr.Civile, aq më tepër kur palët kanë qenë në mungesë. Në çështjen që i përket vendimin nr. 1264-196, datë 07.06.2018, gjyqtari pas zhvillimit të seancës së pajtimit sipas nenit 134 dhe 135 të K.Familjes, ka disponuar me vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, duke vijuar menjëherë seancën gjyqësore (në mënyrë të panderprerë), megjithëse i padituri ka qenë në mungesë në seancën e pajtimit, duke mos i njoftuar të paditurit urdhërin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore sipas parashikimit të nenit 158/c të KPRC, e për pasojë vijimin e gjykimit në mungesë të tij pa u njoftuar rregullisht.

Në çështjet civile themeli, gjyqtari pas zhvillimit të seancës përgatitore, ka disponuar me vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, urdhër i cili në disa raste është i formalizuar (me shkrim) e në disa raste mungon, e për pasojë edhe urdhërimi i gjyqtarit për njoftimin e tij palëve ndërgjyqëse sipas kërkesave të nenit 158/c të KPrC, sidomos kur palët kanë qenë në mungesë. Në ato çështje ku ndodhet vendimi për caktimin e seancës gjyqësore, mungojnë elementët e nevojshëm që ky vendim të jetë i plotë sipas kriterëve të përcaktuar në K.Pr.Civile.

Tek çështja civile, që i përket vendimit nr.1096- 318, datë 24.09.2019 ( e regjistruar pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të bëra me ligjin nr.38/2017 në Kodin e Procedurës Civile), gjyqtari pasi ka kryer veprimet paraprake (konkretisht njoftimin e kërkesë padisë dhe akteve palës së paditur, duke e njohur edhe me të drejtën për të paraqitur deklaratë mbrojtje), ka disponuar me vendim për kalimin e çështjes në seancë përgatitore e më pas në seancë gjyqësore, duke nxjerrë vendimet përkatëse, vendimet të cilat nuk janë arsyetuar, mbi shkaqet që kanë çuar në caktimi i seancës përgatitore dhe më pas zhvillimi i seancës gjyqësore, kur kjo çështje sipas parashikimeve të nenit 162/a të KPRC<sup>141</sup> mund të zgjidhej mbi bazën e

---

<sup>141</sup> Neni 162/a i KPRC, I shtuar me ligjin nr.38/2017 parashikon se:” 1. Paditë me vlerë deri në 150 000 lekë, që rrjedhin nga marrëdhënie kontraktore, shqyrtohen nga gjykata me gjykim të shkurtuar.

2. Shqyrtimi i çështjes me gjykim të shkurtuar para gjykatës bëhet me shkrim. Gjykata mund të zhvillojë seancë gjyqësore verbale nëse e çmon të nevojshme.

3. Në lidhje me gjykimet e padive të mësipërme, zbatohen vetëm rregullat e parashikuara në paragrafin e dytë, të nenit 172, neneve 236/a, 285/a, 310, 315, 460 dhe 510 të këtij Kodi.

akteve. Këto rrethana tregojnë se gjyqtari nuk zbaton siç duhet të gjitha dispozitat procedurale, të ndryshuara, të cilat kanë pasur si qëllim zhvillimin e një gjykimi mbi bazë shkresore, brenda afateve të shkurtra, duke eliminuar seanca të cilat nuk janë të domozdoshme, dhe në përfundim zhvillimin e seancave efektive, duke synuar përfundimin e gjykimit në një seancë të vetme gjyqësore.

Në verifikimi i akteve të dosjes që i përket vendimit nr.1224-380, datë 17.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, gjyqtari në seancë gjyqësore ka pranuar kërkesën e ndërhyrësit kryesor, duke urdhëruar regjistrimin e saj në sekretari, në kundërshtim me nenin 190 të KPRC<sup>142</sup>, dhe me pas ka disponuar me vendim për bashkimin e saj sipas nenit 57 të KPRC<sup>143</sup>, neni i cili gjithashtu, parashikon se një vendim i tillë për bashkimin e çështjeve mund të merret derisa nuk është nxjerrë urdhëri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Gjithashtu, nga aktet e dosjes rezulton se pas pranimit për shqyrtim të padisë së ndërhyrësit kryesor nuk janë respektuar rregullat për njoftimin e saj palëve të paditura sipas përcaktimit të nenit 158 të KPRC, ku parashikohet se;” 1. Gjykata, pasi e vlerëson padinë pa të meta në zbatim të neneve 154/a dhe 156 të këtij Kodi, i kërkon të paditurit të lëshojë deklaratën e mbrojtjes, jo më vonë se 30 ditë nga njoftimi I kërkesëpadisë. Të njëjtat rregulla zbatohen edhe në rastin e paraqitjes së padisë së ndërhyrësit kryesor, ose të kundërpadiesë.”

Në çështjet penale (si në kërkesat penale ashtu dhe penale themeli), rezultoi se gjyqtari në të gjitha rastet ka disponuar me urdhër ose vendim për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes, duke caktuar seancën e parë gjyqësore, dhe duke pasqyruar në këtë akt urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse.

Në çështjet penale themeli, konstatohet se gjithmonë gjykata ka vënë dosjen në lëvizje sikundër parashikohet në nenin 332 të K.Pr.Penale për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, ndërkohë në çështjet penale të themelit në respektim të nenit 333/1 të K.Pr.Penale.

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtari përgjithësisht ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën, si dhe ka treguar kujdes

---

4. Në rast se vlera e padisë është më e vogël se 150 000 lekë dhe vlera e kundërpadiesë tejkalon 150 000 lekë, gjykimi zhvillohet sipas dispozitave të përgjithshme për gjykimin e zakonshëm”

<sup>142</sup> Neni 190 i KPRC, i ndryshuar me ligjin nr.38/2017 parashikon se;” Për të ndërhyrë në një proces civil, sipas nenit 189, të këtij Kodi, personi i tretë duhet të paraqesë kërkesën së bashku me padinë, derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c, të këtij Kodi, duke përmbushur kërkesat e neneve 154 dhe 156 të këtij Kodi.”

<sup>143</sup> Neni 57 i KPRC, i ndryshuar, parashikon se ;” 1. Kur dy ose më shumë padi janë duke u gjykuar në procese të ndryshme dhe lidhen midis tyre për nga objekti ose shkak, mund të bashkohen në një gjykim të vetëm.

2. Vendimin për bashkimin e çështjeve e merr gjykata në të cilën çështja është regjistruar më parë në kohë.

3. Bashkimi i çështjeve mundet të bëhet me kërkesë të palëve ose kryesisht, derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore nga gjykata që merr vendimin.

4. Në rastin kur bashkohen padi, të cilat gjykohen sipas rregullave të gjykimit të shkurtuar me padi që gjykohen sipas rregullave të zakonshme, për gjykimin e çështjes zbatohen rregullat e zakonshme.

5. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin kur kompetenca lëndore në çështjet në gjykim është e ndryshme.”»

maksimal për marrjen e masave për njoftimin e palëve me qëllim zhvillimin e seancave gjyqësore efektive. Megjithatë rezultoi se jo çdo veprim procedural i kryer nga gjyqtari është i dokumentuar, pasi mungojnë vendimet për kryerjen e veprimeve paraprake.

Në lidhje me njoftimin, nga përmbajtja e tyre, konstatohet se ato përgjithësisht janë të plota në raport me të gjitha kërkesat procedurale, por jo gjithmonë përcaktojnë llojin e seancës në të cilën do të paraqitet (përgatitore, pajtimin në çështjet familjare dhe gjyqësore). Gjithashtu, rezultoi që së bashku me njoftimin gjyqtari të ketë urdhëruar dhe njoftuar kërkesë padinë dhe provat në respektim kriterëve ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile si përpara ndryshimeve ashtu edhe pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr.38/2017, fletëthirrja përmban të drejtat e viktimës (kur i drejtohet viktimës së veprës penale), njoftimin për zhvillimin në mungesë në rast mosparaqitje, njoftimin për detyrimin e pagesës së taksës etj. Nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë.

Drejtimi i procesit gjyqësor përgjithësisht ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*) ashtu edhe në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*) apo sipas rritit të gjykimit të zhvilluar (*nenit 405 e vijues të K.Pr.Penale në rastin e gjykimit të shkurtuar*), apo sipas rritit të gjykimeve të seancave paraprake (*neni 332/c i K.Pr.Penale i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017*).

Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit apo të paditurve, shpallja e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj*). Drejtimi i seancës zhvillohet në përgjithësi nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes. Gjithashtu rezultoi që përgjithësisht gjykata ka disponuar me vendime të ndërmjetme mbi çdo kërkesë të parashtruar nga palët në gjykim apo edhe vendimet e ndërmjetme të marra kryesisht si ato për marrjen e provave nga të tretë apo kryerjen e aktit të ekspertimit teknik.

Në dosje të vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, (por në disa raste janë verifikuar vonesa më shumë se 15 min). Pavarësisht kësaj, nuk ka rezultuar në asnjë rast që vonesa të jetë bërë shkak për moszhvillimin e seancës gjyqësore.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio si dhe dokumentohen me shkrim nga

sekretari gjyqësor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë duke theksuar se *“Brenda disa ditëve dhe afateve ligjore nga ana ime është proceduar me çështjen sipas natyrës së saj, duke e studiuar e vlerësuar nëse është pa të meta, duke caktuar seancën apo proceduar duke ftuar palët për deklaratë mbrojtje, dokumentimin e çdo veprimi apo vendimi, etj.”*.

## **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se Gjyqtari ka treguar shkallë aftësie mesatare në këtë tregues, evidentuar përgjithësisht në shpejtësinë dhe korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit të seancave përgatitore apo gjyqësore, duke respektuar përgjithësisht standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur përgjithësisht me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil. Nuk konstatohet i njëjti kujdes nga gjyqtari në raport me kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve procedurale sipas rregullave procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile (pas ndryshimeve), që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë, argumentimin e vendimit për kalimin e çështjes në seancë përgatitore, kryerja e seancave përgatitore efektive (pasi përgjithësisht këto seanca kanë qenë formale), caktimin e ekspertit psikolog në seancë gjyqësore, në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në nenin 158/b të KPRC, me kalimin e çështjes me seancë gjyqësore si dhe me kryerjen e veprimeve procedurale pas nxjerrjes së urdhërit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, kur Kodi parashikon se vendime të tilla mund të merret përpara këtij momenti procedural.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin *“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”* është *“Mesataren”* dhe pikëzohet me 12 pikë.*

## **2.C AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE.**

### ***2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.***

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në këtë kuptim përgjithësisht renditja ka filluar me aktet që kanë vënë në lëvizje gjykatën, aktet e paraqitura nga palët para fillimit të seancave, veprimet dhe vendimmarrjet e gjykatës gjatë veprimeve paraprake, nëse ka. Më pas kalohet tek procesverbalet, parashtrimet e palëve etj., gjithmonë sipas datës së zhvillimit të seancës. Në

rastin konkret renditja sipas llojit të akteve procedurale por e ndërthurur kjo edhe me veprimet procedurale të kryera nga gjyqtari gjatë gjykimit, është dhe konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të aksesueshme dosjen. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (*njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave*). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, por nuk ka dhënë shpjegime.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik (sipas kategorisë) dhe kronologjike (brenda së njëjtës kategori aktesh), është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.*

### ***2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.***

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, është përfshirë vetëm dokumentacioni që i ka shërbyer zhvillimit të procesit gjyqësor konkret, duke filluar nga momenti i shortimit deri në dhënien e vendimit përfundimtar (*njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance përgatitore apo gjyqësore, vendimet për caktimin e seancave gjyqësore në ato raste kur është, vendimet e ndërmjetme të arsyetuara, vendimet gjyqësore*) si dhe aktet e paraqitura nga palët (*kërkesë padia, provat dhe diskutimet përfundimtare të palëve*). Në dosjet gjyqësore mungon gjithmonë vendimi apo urdhëri për kryerjen e veprimeve paraprake, megjithëse rezulton se veprimet paraprake janë kryer rregullisht. Gjithashtu në disa raste mungon apo nuk administrohet vendimi apo urdhëri i gjykatës për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, e për pasojë nuk rezulton t'i jetë njoftuar rregullisht palëve ndërgjyqëse sipas nenit 158/c të KPrC.



Në dosjet penale rezulton që bashkë me njoftimin (letërthirrjes) të pandehurit, personit nën hetim apo të dëmtuarit i janë njoftuar edhe të drejtat e parashikuara në nenin 34/a dhe nenin 58 të K.Pr.Penale, duke i bërë ato pjesë të njoftimit, sipas parashikimeve në nenet 34/a<sup>144</sup>, 58<sup>145</sup>, 140<sup>146</sup> paragrafi 1 dhe 137<sup>147</sup> i K.Pr.Penale.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, por nuk ka dhënë shpjegime.

## KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë të lartë aftësie për këtë tregues, pasi në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete apo mungesa të akteve të që lidhen me çështjen konkrete.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit në treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
92	Shkëlqyeshëm

### 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

<sup>144</sup> Në nenin 34/a. pika 2 dhe 3 të K.Pr.Penale parashikohet se: “2. Përpara marrjes në pyetje për herë të parë ose përpara kryerjes së akteve ku prania e tij është e detyrueshme, sipas ligjit, organi procedues e njofton të pandehurin për të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit, letrën e të drejtave në formë të shkruar.

3. Të drejtat dhe garancitë e parashikuara për të pandehurin zbatohen edhe për personin nën hetim dhe personin, të cilit i atribuohet vepra penale, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe.”.

<sup>145</sup> Neni 58 pika 2 i K.Pr.Penale parashikon se ; » 2. Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre. »

<sup>146</sup> Neni 140 paragrafi 1 parashikon se;”1. Njoftimi për herë të parë i të pandehurit në gjendje të lirë bëhet duke i dorëzuar atij personalisht kopjen e aktit së bashku me letrën e të drejtave, sipas nenit 34/a, të këtij Kodi. Kur nuk mund t’i dorëzohet personalisht, njoftimi bëhet në banesën e tij ose në vendin e punës, duke ia dorëzuar aktin një personi që bashkëjeton me të ose një fqinji, ose një personi që punon me të. Në aktin e njoftimit tregohen gjenealitetet e personit që merr përsipër njoftimin dhe lidhja e tij me të pandehurin.”

<sup>147</sup> Neni 137 paragrafi i 1 parashikon se: “1. Njoftimet për personin e dëmtuar nga vepra penale bëhen njëjloj si për rastet kur njoftohet për herë të parë i pandehuri i lirë.”

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

### **3.A ETIKA NË PUNË**

#### ***3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.***

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me të dhënat që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit u konstatuan këto të dhëna:

Referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë<sup>148</sup>, rezulton se ndaj gjyqtarit {...} në periudhën e vlerësimit 2017-2019 rezulton se janë depozituar 7 ankesa, një çështje e transferuar për inspektim nga KPK dhe dy informacione:

- Ankesë e ankuesit Petrit Doçi, ankesë e depozituar pranë ish-KLD-së, regjistruar me nr. 2492 prot., datë 07.09.2018, e cila më pas është regjistruar pranë ILD-së me nr. 767 prot., datë 09.02.2021. Pas shqyrtimit fillestar, është konstatuar se ankesa është e përsëritur dhe është trajtuar me relacionin e datës 08.11.2018. Gjithashtu, është konstatuar se ankesa lidhet me përjashtimin e gjyqtarit subjekt vlerësimi, pretendim i cili është realizuar disa herë prej ankuesit referuar nenit 72 të K.Pr.Civile në gjykatë. Në këto kushte, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendimin nr. 3969/3 prot., datë 17.01.2022 *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të paraqitura nga shtetasi Petrit Doçi...”*.
- Informacion periodik i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, përcjellë nga ish-KLD me nr. 3464/3 prot., datë 15.02.2018, e cila më pas është regjistruar pranë ILD-së me nr. 652 prot., datë 05.02.2021. Referuar këtij informacioni, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, ka raportuar një çështje që i përket gjyqtarit subjekt vlerësimi, e cila është ende në gjykim në shkallën e parë megjithëse kanë kaluar dy vjet. Referuar verifikimeve të kryera dhe analizës së veprimtarisë së gjyqtarit subjekt vlerësimi, është konstatuar se ai ka zhvilluar një gjykim në përputhje me normat procedurale dhe të gjitha veprimet e kryera prej tij janë në përputhje me parimin e arsyesmërisë. Në këto kushte, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendimin nr. 2825/1 prot., datë 06.10.2023 *“Për arkivimin pas verifikimit të informacioneve periodike të ardhura nga Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë mbi çështjet e zvarritura mbi 2 vjet për muajin tetor 2017 dhe muajin janar 2018...”*.

---

<sup>148</sup> Shkresa nr. 2715/1 prot., datë 21.10.2022, nr. 1046/1 prot., datë 02.05.2023, nr. 1385/1 prot., datë 09.05.2023, nr. 1905/1 prot., datë 04.07.2023, nr. 2686/1 prot., datë 25.09.2023.

- Ankesë e ankuesit Idriz Tafa, ankesë e depozituar pranë ish-KLD-së, regjistruar me nr. 455/3 prot., datë 01.11.2018, e cila më pas është regjistruar pranë ILD-së me nr. 381 prot., datë 29.01.2021. Përmes kësaj ankese, ankuesi ngre pretendime për zvarritje të gjyqimit në lidhje me procesin gjyqësor në të cilën ai është thirrur në cilësinë e viktimës. Pas verifikimit të kryer, është konstatuar se ka kaluar afati i parashkrimit, e për rrjedhojë duke vlerësuar mospërmbushjen e kriterit të pranueshmërisë referuar nenit 117 të ligjit nr. 96/2016, me vendimin nr. 691/1 prot., datë 28.03.2023, Inspektori i Lartë i Drejtësië ka disponuar *“Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Idriz Tafa.”*
- Informacion periodik i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, përcjellë prej ish-KLD me nr. 3828/1 prot., datë 05.02.2017, e cila më pas është regjistruar pranë ILD-së me nr. 919 prot., datë 16.02.2021. Referuar shkresës nr. 1385/1 prot., datë 09.05.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezulton se ky informacion periodik i përket vitit 2016, e rrjedhimisht nuk është objekti i vlerësimit të gjyqtarit për periudhën e vlerësimit 1 janar 2017- 31 dhjetor 2019.
- Ankesë e ankuesit Tafil Tafili, ankesë e depozituar pranë ish-KLD-së, regjistruar me nr. 3263/3 prot., datë 10.05.2018, e cila më pas është regjistruar pranë ILD-së me nr. 366 prot., datë 29.01.2021. Përmes kësaj ankese, ankuesi ka kërkuar të verifikohet dosja e tij gjyqësore kundër z. Albert Pjetri duke qënë se ka 20 vjet në proces. Pas verifikimit të kryer, është konstatuar se ka kaluar afati i parashkrimit, e për rrjedhojë duke vlerësuar mospërmbushjen e kriterit të pranueshmërisë referuar nenit 117 të ligjit nr. 96/2016, me vendimin nr. 383/1 prot., datë 15.03.2023, Inspektori i Lartë i Drejtësië ka disponuar *“Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Tafil Tafili.”*
- Ankesa të ankuesit Prokuroria e Përgjithshme, të depozituar pranë ish-KLD-së, regjistruar me nr. 695/3 prot., datë 13.06.2018 dhe nr. 695/4 prot., datë 20.06.2018, të cilat më pas janë regjistruar pranë ILD-së me nr. 404 prot., datë 01.02.2021 dhe nr. 404/1 prot., datë 01.02.2021. Përmes këtyre ankesave, ankuesi ngre pretendime për mosrespektim të ligjit formal prej gjyqtarit subjekt vlerësimi në vendimin nr. 1423-211, datë 18.10.2017 dhe nr. 1424-210, datë 18.10.2017. Pas verifikimit të kryer, është konstatuar se ka kaluar afati i parashkrimit, e për rrjedhojë me vendimin nr. 1449/1 prot., datë 15.05.2023, Inspektori i Lartë i Drejtësië ka disponuar *“Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm.”*
- Ankesë e ankuesit Tom dhe Enrik Mamli, ankesë e depozituar pranë ish-KLD-së, regjistruar me nr. 3391 prot., datë 26.11.2018, e cila më pas është regjistruar pranë ILD-së me nr. 1086 prot., datë 19.02.2021. Përmes kësaj ankese, ankuesit pretendojnë se ata ndodhen në IEVP në bazë të një vendimi të padrejtë (nr. 214-14, datë 01.02.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin) dhënë prej gjyqtarit subjekt vlerësimi, vendim i cili rezulton të jetë lënë në fuqi edhe prej Gjykatës së Apelit Tiranë. Pas shqyrtimit fillestar të kësaj ankese, duke patur në konsideratë se pretendimet e ankuesve në thelb lidhen me mënyrën e zgjidhjes së çështjes gjyqësore, atribut i cili i përket vetëm pushtetit gjyqësor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vlerësuar se ankesa nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në nenin

120/1 pika d dhe dh të ligjit nr. 96/2016. Rrjedhimisht, me vendimin nr. 1080/2 prot., datë 21.01.2022 ka disponuar *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasit Tom dhe Enrik Mamli.”*

- Ankesë e ankuesit Arlind Ahmetaj, ankesë e depozituar pranë ish-KLD-së, e cila më pas është regjistruar pranë ILD-së me nr. 1567 prot., datë 08.07.2020. Përmes kësaj ankese, ankuesi ngre pretendime në lidhje me vendimet e datës 27.08.2019 dhe nr. 16.12.2019, që i përkasin çështjes nr. 243-331 akti. Sipas ankuesit, gjyqtari ka zhvilluar seancën gjyqësore në mungesë të të paditurve, ndërkohë që këta të fundit nuk kishin dijeni për datën dhe orën e seancës. Gjithashtu, sipas ankuesit, gjyqtari me sjelljen e tij, ka cenuar rëndë vlerat, parimet dhe standardet mbi të cilat duhet të udhëhiqet veprimtaria e një gjyqtari gjatë ushtrimit të funksioneve të tij. Pas shqyrtimit fillestar të kësaj ankese, duke patur në konsideratë se ankesa është e përsëritur, e për rrjedhojë nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendimin nr. 1202/1 prot., datë 15.05.2023 *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi Arlind Ahmetaj...”*
- Ankesa të ankuesit Petrit dhe Lumturi Doçi, regjistruar pranë ILD-së me nr. 858 prot., datë 03.06.2020, nr. 847 prot., datë 02.06.2020, nr. 1125 prot. dhe nr. 1151/1 prot., datë 15.06.2020, nr. 1125/3 prot., datë 29.06.2020, nr. 1125/6 prot., datë 06.07.2020, nr. 1125/7 prot., datë 08.07.2020, nr. 1125/8 prot., datë 14.07.2020, nr. 1125/9 prot., datë 04.07.2020, nr. 1125/10 prot., datë 14.07.2020, nr. 1125/11 dhe nr. 1125/12 prot., datë 21.07.2020, nr. 1125/13 dhe nr. 1125/14 prot., datë 22.07.2020, nr. 1125/15 prot., datë 27.10.2020, nr. 842/2 prot., datë 05.10.2020, nr. 1123 prot., datë 15.06.2020, nr. 774 prot., datë 01.06.2020, nr. 122 prot., datë 17.02.2020, nr. 1003 prot., datë 09.06.2020, nr. 141 prot., datë 20.01.2021, nr. 1430 prot., datë 01.07.2020, nr. 839/5 prot., datë 04.11.2020, nr. 839/4 prot., datë 04.11.2020, nr. 839/3 prot., datë 08.10.2020, nr. 839/2 prot., datë 08.10.2020, nr. 839 prot., datë 02.06.2020, nr. 140/2 prot., datë 10.02.2021 dhe nr. 1819 prot., datë 27.07.2020. Duke qënë se përmes këtyre ankesave, ankuesi ka ngritur pretendime që iu referohen fakteve të njëjta dhe magistratëve të njëjtë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur bashkimin e tyre dhe trajtimin e përbashkët në të njëjtin akt. Pas shqyrtimit fillestar, duke patur në konsideratë se pretendimet e ankuesit ndaj veprimeve apo mosveprimeve të gjyqtarit subjekt vlerësimi në thelb lidhen me mënyrën e zgjidhjes së çështjes gjyqësore, atribut i cili i përket vetëm pushtetit gjyqësor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vlerësuar se ankesat e bashkuara nuk plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në nenin 120/1 pika d dhe dh të ligjit nr. 96/2016. Rrjedhimisht, me vendimin nr. 2018/3 prot., datë 26.07.2022 ka disponuar *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të shtetasve Petrit dhe Lumturi Doçi.”*
- Çështje e transferuar për inspektim prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me shkresën nr. 1744 prot., datë 04.05.2022, regjistruar pranë ILD-së me nr. 1167 prot., datë 05.05.2022. Në themel të kësaj çështje qëndron ndryshimi i vendimit të dhënë prej gjyqtarit subjekt vlerësimi nga Gjykata e Apelit, në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal. Pas shqyrtimit fillestar të saj, është konstatuar se çështja ndodhet në Gjykatë të Lartë dhe për rrjedhojë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, duke vlerësuar se

nuk mund të marrë atributet e një gjykate më të lartë, ka marrë vendimin nr. 1167/2 prot., datë 21.07.2022 “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të rastit të paraqitur nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për magistratin z. {...} me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin”.

Sikurse rezulton nga shkresat e mësipërme, të gjitha ankesat që janë bërë ndaj gjyqtarit janë arkivuar.

Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se për periudhën 01.01.2017-31.12.2019 për gjyqtarin {...}, nuk është depozituar asnjë vendim i tillë prej organeve kompetente dhe për rrjedhje Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk disponon informacionin e kërkuar.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë duke theksuar se “Gjatë punës time jam kujdesur të përkrah kolegët në përmbushjen e detyrës, e të ofroj një shembull të mirë edhe për kolegët e rinj, që i janë bashkuar gjykatës të ndaj e diskutoj me ta problematikat e punës, lidhur me administrimin e gjykatës si pjesë tashmë edhe e këshillit të gjykatës apo çështje të kuptimit e interpretimit të drejtë të ligjit apo institutit të ri apo të ndryshuar, të përkrah nismat e mira dhe unifikuar zgjidhjet ligjore të çështjeve brenda gjykatës në kuptimin e praktikave të mira gjyqësore, të jem i përmbajtur dhe njëkohësisht i përfshirë në bashkëpunimin me kolegët për përmbushjen e objektivave të gjykatës.”.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të çënojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

*Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e etikës së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.*

### **3.B INTEGRITETI I GJYQTARIT**

#### **3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2017 - 31.12.2019, rezulton se për gjyqtarin {...} është depozituar dy ankesa dhe një informacion të cilat janë arkivuar.

Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se nuk është depozituar asnjë vendim i tillë prej organeve kompetente dhe për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk disponon informacionin e kërkuar.

Referuar raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 3349/2 prot. datë 18.11.2022, rezulton se: a) *Deklaratat e interesave private periodike/vjetore 2017-2020 janë dorëzuar brenda afateve ligjore; b) Gjatë kontrollit u konstatua se deklaratat e interesave private janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit; c) Nga kontrolli i ushtruar nuk u verifikuan raste të konfliktit të interesave.*

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë duke theksuar se *“Nuk kam manifestuar sjellje të pahijshme me palët, avokatët apo pjesmarrësit e tjerë si gjatë gjykimit e punës, ashtu dhe jashtë tyre. Jam kujdesur që vetë por dhe familja ime të manifestojnë sjellje dinjitoze në shoqëri që nuk cënon imazhin e detyrës që unë ushroj. Besoj ia kam arritur me sukses.”*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

## **KONKLUZIONI**

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, vlerësoj se gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e integritetit të gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

## **3.C PAANËSIA E GJYQTARIT**

### ***3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.***

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit

shkresor, akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarit.

Gjyqtari lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivelin shumë të lartë.

#### **KONKLuzioni**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

#### **3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2017–31.12.2019, janë paraqitur 6 kërkesa për përjashtimin e subjektit të vlerësimit, nga të cilat asnjë nuk është pranuar. Ndërkohë, rezulton se vetë subjekti i vlerësimit ka paraqitur 24 kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 22 janë pranuar.

Gjyqtari e ka vlerësuar numrin e kërkesave të pranuar për përjashtim si të pakonsiderueshëm, por nuk ka dhënë shpjegime.

#### **KONKLuzioni**

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, nuk është pranuar asnjë nga 6 kërkesat për përjashtimin e tij dhe nga 24 kërkesa për heqje dorë, janë pranuar 22 prej tyre.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, vlerësohet se ky numër është “I pakonsiderueshëm” dhe pikëzohet me 15 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

#### **4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL**

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

##### **4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT.**

##### **4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë dhe transparent. Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë dhe drejtpërdrejtë. Në përgjithësi, gjyqtari përdor fjalë të thjeshta dhe të drejtpërdrejta, si dhe ndërton fjali me gjatësi mesatare, të cilat lidhen me njëra tjetrën për nga vijimësia e mendimit. Konstatohet gjithashtu përdorimi i fjalive të gjata me qëllim mosndërprerjen e logjikës së arsyetimit.

Gjyqtari, lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivel shumë të lartë.

##### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.



*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.*

#### **4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk konstatohet që gjyqtari të ketë ceduar në ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat ai është në djeni për shkak të funksionit.

I njëjti konstatim rezulton edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio.

Gjyqtari, lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e tij në nivel të lartë.

### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast ka respektuar konfidencialitetin dhe të dhënat personale të palëve duke treguar aftësi të larta në drejtim të këtij treguesi.

*Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.*

#### **4.B AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR.**

##### **4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjithashtu rezulton se në ILD janë depozituar 7 ankesa, një çështje e transferuar për inspektim nga KPK dhe dy informacion të cilat janë arkivuar. Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se nuk është depozituar asnjë vendim i tillë prej organeve kompetente dhe për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk disponon informacionin e kërkuar.

Gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, por pa dhënë shpjegime.

#### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.*

#### **4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna që negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, por pa dhënë shpjegime.

#### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.*

#### **4.C GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.**

##### **4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari {...}, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2017-31.12.2019, ka marrë pjesë në Programin e

Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrësit. Konkretisht, rezulton se gjyqtari {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese si më poshtë:

- (i) Në cilësinë e pjesëmarrësit në Programin e Formimit Vazhdues në 14 (katërbëdhjetë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit (nga data 13.03.2017 deri në datë 20.11.2019), gjithsej 19 ditë trajnimi.

## **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës dhe jashtë saj, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 14 aktivitete të zhvilluara për 19 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

*Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është brenda kufijve 15-120 ditë dhe pikëzohet me 20 pikë.*

### **4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton se gjyqtari të jetë angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësuesit apo ekspertit.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimi të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtarin {...} duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij në cilësinë e lehtësuesit apo ekspertit në aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

Në formularin e vetëdeklarimit, gjyqtari {...} ka deklaruar se: *“Jam i gatshëm të udhëheq kandidatë për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe si lehtësues në trajnimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, për tema ku kam ekspertizë dhe njohuri më të thelluara”*

## KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari nuk është angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësues apo ekspert pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe nuk rezulton të ketë udhëhequr kandidatë për gjyqtarë gjatë ztazhit profesional.

*Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” nuk rezulton angazhimi i gjyqtarit dhe për pasojë pikëzohet me 3 pikë.*

### **4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton të ketë të dhëna për këtë tregues.

Në formularin e vetëdeklarimit, gjyqtari {...} ka deklaruar se: “Pavarësisht ngarkesës në punë, jam përpjekur dhe kam marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare, me qëllim përfaqësimin dhe trajnimin për çështje ligjore, institute ndërkombëtare, si bashkëpunimi ndërkombëtar në fuqizimin e rolit të viktimave në procesin penal, me temën VICTIMS' RIGHTS IN THE EU IN PRACTICE 3-4 DECEMBER 2019- L'Institut de Formation Judiciaire (IFJ) / Instituut voor Gerechtelijke Opleiding (IGO), Avenue Louise 54, Ixelles, 1050, Brussels, Belgium, i organizuar nga EJTN. Por, për shkak se këto aktivitete kërkojnë kohë dhe shpesh na punë disa ditore dëshiroj të marrë pjesë, veçse nëse organizohen e planifikohen të paktën 6–muaj përpara. Gjithashtu, jam i hapur të bashkëpunoj sidomos me shoqërinë civile në projekte, me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike të edukimit ligjor e qytetar, mjafton të organizohen jashtë orarit të punës, sidomos në ditët e pushimit javor.”

Lidhur me këtë tregues në Metodolinë e Pikëzimit parashikohet se:”Gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislativitetit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm

*me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimit të publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike”.*

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtarin {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij.

## **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

***Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se në treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtari pikëzohet me 3 pikë, pasi nuk ka të dhëna për angazhimin e tij në këto veprimtari.*

### **4.C.ç Publikimet ligjore akademike.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezulton që gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit të ketë publikuar punime akademike.

Në formularin e vetëdeklarimit, gjyqtari {...} ka deklaruar “Përveç vendimeve gjyqësore, kam publikime ndër vite si:

- *A cenohet parimi i procesit të rregullt ligjor sipas Nenit 6 të konventës nga caktimi i mbrojtësit nominalisht prej gjykatës, bashkëautori i artikullit të botuar, në Revistën Jeta Juridike Nr.2 Qershor 2013 të Shkollës së Magjistraturës.*
- *Fitimi i munguar si dëm jashtëkontraktor dhe problematikat gjyqësore lidhura me të, bashkëautori i punimit të botuar, Revista Jeta Juridike nr.4, viti 2015 të Shkollës së Magjistraturës ISSN 2219–4134...”*

Publikimet të cilat përmend Z. {...} në formularin e vetëvlerësimit nuk i përkasin periudhës së vlerësimit 2017-2019 dhe për pasojë nuk do të merren në konsiderastë për sa i takon pikëzimit. Ato janë marrë parasysh dhe vlerësuar nga Këshilli në periudhën e vlerësimit 2013-2016.

## KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 0 pikë.

*Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Publikime ligjore akademike” gjyqtari pikëzohet me 0 pikë, pasi nuk rezultojnë publikime të gjyqtarit.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

## F- PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

*Në këtë pjesë, relatori, bazuar në parashikimet e nenit 93, pika 5, shkronja “c” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi bazën e pikëzimit të kryer prej tij, propozon nivelin e vlerësimit për secilin nga katër kriteret e vlerësimit si dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit të gjyqtarit.*

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	88	Shumë mirë
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	92	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	371	Shumë mirë

## **PROPOZIME DHE REKOMANDIME**

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandoj që gjyqtari {...} t’i kushtojë më shumë rëndësi pjesës së përshkrimit të rrethanave të faktit, analizës ligjore të vendimit, të argumentit logjik, si dhe strukturimit të vendimit si nga pikpamja e formës ashtu edhe nga përmbajtja, të mbajë në konsideratë angazhimin e tij në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

## **SHTOJCA 1**



**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE  
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN {...}  
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2017 - 31 DHJETOR 2019**

<b>1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>	
				<b>88</b>	<b>Shumë mirë</b>	
<b>Treguesit</b>	<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e aftësisë</b>	<b>Pikët</b>	<b>Të dhëna për metodologjinë</b>		
<b>A. Njohuritë ligjore</b>	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesatare	20	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesataren	20	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
<b>B. Arsyetimi ligjor</b>	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë	

		përzgjedhura për vlerësim			Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesataren	8	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
<b>2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>92</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë</b>	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	15	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë

					0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	5	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	<b>Koha mesatare:</b> Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i	+99%	10	<b>Tej standardit :</b> Nën 81%- 2 pikë Mbi 81-87% - 4 pikë

		kryetarit			Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1.Të dhënat statistikore 2.Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	<b>Koha mesatare:</b> Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
<b>B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer</b>	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të	1.Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e	15	<b>Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b>

<b>procedural gjqësore</b>	nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	aftësisë		Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mesatare	12	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
<b>C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore</b>	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	5	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit	
				100	Shkëlqyeshëm	
Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia		
<b>A. Etika në punë</b>	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	<b>Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit:</b> E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë	
<b>B. Integriteti i gjyqtarit</b>	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	<b>Shkalla e integritetit të gjyqtarit :</b> E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë	
<b>C. Paanësia e gjyqtarit</b>	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	<b>Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë	

	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	<b>Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit:</b> Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
<b>4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>91</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Aftësia e komunikimit</b>	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	<b>Qartësia dhe transparenca e komunikimit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	<b>Respektimi i konfidencialitetit:</b> I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
<b>B. Aftësia për të</b>	a. Shkalla e komunikimit dhe	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e komunikimit:</b>

<b>bashkëpunuar</b>	bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave			E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë	
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë	
<b>C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera</b>	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)	20	<b>Pjesëmarrja e gjyqtarit:</b> (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4	
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna		3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e	Nuk ka të dhëna		3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë



	marrëdhëniet me publikun në gjykata	gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit			
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk a të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
<b>PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT</b>			<b>371</b>		
<b>IVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT</b>			<b>Shumë mirë</b>		

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

